

PËRMBLEDHJE
E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË PROJEKTIT TË BE-së

MBËSHTJETJE PËR KËSHILLIN GJYQËSOR TË KOSOVËS DHE KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS

Kontributet kryesore të projektit për zhvillimin e Këshillave
nga viti 2011 deri në 2016
Vlerësimi i mbështetjes së Projektit për Këshillat
Rezultatet e Arritura
Aspektet kyçe për zhvillimin e mëtutjeshëm të KGJK dhe KPK



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i
menaxhuar nga Zyra e Bashkimit
Evropian në Kosovë



MBËSHËTETJE PËR KËSHILLIN GJYQËSOR TË KOSOVËS DHE KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS
KONTRATA 2011 / 271 – 244 & 2014 / 350 – 729



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i
menaxhuar nga Zyra e Bashkimit
Evropian në Kosovë



Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e Zyrës së BE-së në Kosovë. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Human Dynamics dhe nuk mund të konsiderohet në asnjë mënyrë se pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian.

PËRGATITUR NGA: Ekipi i Projektit
UDHËHEQËSE E EKIPIT Znj. Anita Mihailova

PËR PROJEKTIN

Projekti i financuar nga BE 'Mbështetje për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës' është implementuar nga Tetori 2011 deri në Prill 2016. Qëllimi i Projektit ka qenë që të zhvillohet dhe fuqizohet pavarësia, performanca, profesionalizmi dhe efikasiteti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës deri në nivelin Evropian.

PËRHUMAN DYNAMICS:

Human Dynamics është ofrues i specializuar i shërbimeve të konsulencës për klientët e sektorit publik, me fokus në shtetet në tranzicion dhe ato në zhvillim. Ne punojmë në zhvillimin institucional, infrastrukturor dhe gjyqësor, duke iu ndihmuar klientëve që të arrijnë sukses. Ne arrijmë rezultate dhe ndikim të shkëlqyeshëm për Klientët në të gjitha nivelet — organizata ndërkombëtare, qeveri shtetërore, autoritete rajonale dhe komunale. Kompania është fituese e çmimeve dhe qëndron për ndikim, inovacion, performancë, qëndrueshmëri dhe ekspertizë.

MBËSHËTETJE PËR KËSHILLIN GJYQËSOR TË KOSOVËS DHE KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS
KONTRATA 2011 / 271 – 244 & 2014 / 350 – 729

TABELA PËRMBAJTJES

- 5..... Hyrje
- 7..... Karakteristikat kryesore të Projektit
- 12..... Sfondi
- 14..... Kontributet kryesore të Projektit për zhvillimin e Këshillave, ndarë sipas viteve
- 26..... Vlerësimi i mbështetjes së Projektit sipas fushave, rezultatet e arritura dhe aspektet kyçe për zhvillimin e mëtutjeshëm të Këshillave
- 27.....Zhvillimi organizativ dhe funksional i KGJK dhe KPK
- 32.....Emërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve
- 37.....Vlerësimi i performancës, transferimit dhe ngritjes në detyrë të gjyqtarëve dhe prokurorëve
- 42..... Ngritja në detyrë dhe transferimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve
- 46.....Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe prokurorëve
- 50.....Sistemi Qendror Shtetëror i Dosjeve Penale (SQSHDP)
- 54..... Koordinimi me Partnerët tjerë Ndërkombëtarë
- 56..... Menaxhimi i Projektit
- 58..... Përmbajtja e Raportit Përfundimtar
- 60..... Ekipi i Projektit

HYRJE

Ky publikim është përgatitur për Konferencën Përfundimtare të Projektit dhe ka për qëllim prezantimin e gjetjeve, konkludimeve, arritjeve dhe rekomandimeve kryesore të Projektit të BE-së 'Mbështetje për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës'.

Publikimi përmban një përmbledhje të Raportit Përfundimtar të Projektit që përmban një analizë dhe vlerësim të plotë të të gjitha aktiviteteve të Projektit të përfunduara nga Tetori 2011 deri në Prill 2016. Prandaj, kjo përmbledhje nuk duhet konsideruar si zëvendësim i Raportit Përfundimtar dhe shtojcave përkatëse të tij.

Në këtë përmbledhje është theksuar mbështetja e vazhdueshme e Projektit për këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, rezultatet kryesore të arritura dhe fushat në të cilat ka nevojë për mbështetje të mëtutjeshme për Këshillat nga partnerët ndërkombëtar.

KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË PROJEKTIT

Kontraktuesit

Projekti i Bashkimit Evropian “Mbështetje për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës” është implementuar nga një konsorcium ndërkombëtar i udhëhequr nga Hulla&Co Human Dynamics KG (Austri) dhe partnerët e konsorciumit: DMI Associates SARL (Francë) dhe Conselho Superior da Magistratura (Portugali).

Kohëzgjatja

Projekti ka filluar me 13 Tetor 2011. Kohëzgjatja e Projektit e paraparë në TR ka qenë tri vite – nga Tetori 2011 deri në Tetor 2014.

Projekti ka përfunduar me sukses të gjitha aktivitetet e parapara në planin fillestar tre vjeçar. Për shkak të suksesit të Projektit, kërkesës së përfituesve dhe me vendim të autoritetit kontraktues, Projekti është vazhduar në Tetor 2014 nga 36 muaj sa ishte paraparë fillimisht në 54 muaj.

Kohëzgjatja përfundimtar e Projektit është **54 muaj –nga Tetori 2011 deri në Prill 2016.**

Objektivat e përgjithshme të Projektit

Objektivi i përgjithshëm i Projektit ka qenë mbështetja e vazhdueshme e përpjekjeve për zhvillimin e sistemit gjyqësor në Kosovë në përputhje me standardet e BE, përmes rritjes së pavarësisë së këtij sistemi dhe përmirësimit të performancës së tij.

Qëllimi i Projektit

Qëllimi i Projektit ka qenë zhvillimi dhe rritja e pavarësisë, performancës, profesionalizmit dhe efikasitetit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës deri në nivelin e pritur të standardeve Evropiane dhe mbështetja strategjike e Këshillave për zhvillimin e kapaciteteve të tyre organizative dhe profesionale për ushtrimin e mandateve përkatëse në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Përfituesit

Përfituesit kryesor dhe të drejtpërdrejtë të Projektit janë Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës. Përfitues të aktiviteteve të projektit janë edhe Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD) dhe Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK).

Përfituesit e tërthortë që kanë përfituar nga përmirësimi i funksionimit të dy Këshillave, përfshijnë të gjitha organet dhe personat që janë pjesë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë.

Përfituesit e tretë dhe përfundimtar të Projektit janë shoqëria kosovare, që ka nevojë për profesionistë të kualifikuar ligjor dhe për një sistem gjyqësor dhe prokurorial të menaxhuar mirë dhe që është në gjendje që ti gjykojë rastet me shpejtësi dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi, për vendosjen e sundimit të ligjit.

Komponentët dhe rezultatet e planifikuara

Projekti është zbatuar përmes katër Komponentëve, të cilët kanë qenë përgjegjës për arritjen e rezultateve specifike në vijim:

Komponenti 1: Mbështetje Organizative për Këshillin Gjyqësor të Kosovës / Këshillin Prokurorial të Kosovës

- Struktura dhe efikasiteti i KGJK/KPK fuqizohen, për t'iu lejuar që të ushtrojnë detyrat në mënyrë efektive. Ligjet, aktet nënligjore, udhëzimet etj. të nevojshme për rregullimin dhe mbështetjen e punës miratohen.
- Miratohen organogramet dhe përshkrimet e detyrave të punës për dy Këshillat.
- Krijohen strukturat ekuivalente dhe korniza ligjore përkatëse për ZPD.
- Zhvillohen dhe fuqizohen kapacitetet për hartimin / përditësimin dhe zbatimin e planeve strategjike (afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjate). Planet strategjike zhvillohen nga dy Këshillat.
- Fuqizohet struktura dhe efikasiteti i KGJK/KPK, duke i lejuar Këshillave që të ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë efektive lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e Planeve Strategjike, hulumtimit dhe zhvillimit të politikave, buxhetit dhe menaxhimit e burimeve njerëzore.
- Zhvillohen kapacitetet dhe llogaridhënia e anëtarëve të KGJK/KPK për përmbushjen e detyrave të tyre.

Komponenti 2: Mbështetje për zhvillimin e një sistemi të Emërimit, Vlerësimi dhe Disiplinor për Gjyqtarë

- Zhvillimi i një sistemi plotësisht funksional, i pavarur dhe transparent për emërimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve. Caktimi i

kritereve dhe procedurave relevante, duke përfshirë implementimin e rregullt të tyre sipas praktikave të mira të BE-së. Gjithashtu, procesi në tërësi duhet të jetë në pajtim me modelin e krijuar për vlerësimin/procedurën e ri-emërimit. Komponentët II.2 për vlerësim dhe II.3 për sistemin disiplinor duhet të përbëjnë pjesën e plotë të mekanizmit për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, duke krijuar kështu një mekanizëm gjithëpërfshirës për menaxhimin e burimeve njerëzore.

- Funkcionalizohet plotësisht sistemi i vlerësimit të kapacitetit profesional të gjyqtarëve, duke përfshirë listën e kritereve relevante, si dhe funksionalizohet plotësisht sistemi transparent për mbledhjen e të dhënave homogjene statistikore dhe për miratimin dhe implementimin e procedurave në pajtim me standardet e BE-së.
- Krijohet dhe funksionalizohet një sistemi disiplinor për gjyqtarë me kritere dhe masa të qarta disiplinore (duke përfshirë shkarkimin). Krijohen dhe implementohen procedurat disiplinore relevante dhe transparente, duke respektuar plotësisht të drejtat e personit të përfshirë / akuzuar dhe duke respektuar standardet e përgjithshme të shteteve anëtare të BE-së.
- Konsolidohen masat dhe veprimet e mëtutjeshme për implementimin e rekomandimeve dhe arritjeve lidhur me emërimin, vlerësimin dhe procedurat disiplinore për gjyqtarë.
- Zhvillohet kapaciteti i KGJK-së, Komisioneve dhe personelit mbështetës si dhe krijohen praktikat e mira për emërimin, vlerësimin dhe procedurat disiplinore për gjyqtarë.

Komponenti 3: Mbështetje për zhvillimin e një sistemi të Emërimit, Vlerësimi dhe Disiplinor për Prokurorë

- Zhvillohet një sistem plotësisht funksional, i pavarur dhe transparent për emërimin dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve. Caktimi i kriterëve dhe procedurave relevante, duke përfshirë implementimin e rregullt të tyre sipas praktikave të mira të BE. Gjithashtu, procesi në tërësi duhet të jetë në pajtim me modelin e krijuar për vlerësimin/procedurën e ri-emërimit. Komponentët III.2 për vlerësim dhe III.3 për sistemin disiplinor duhet të përbëjnë pjesën e plotë të mekanizmit për ngritjen në detyrë të prokurorëve, duke krijuar kështu një mekanizëm gjithëpërfshirës për menaxhimin e burimeve njerëzore.
- Funksionalizohet plotësisht sistemi për vlerësimin e kapacitetit profesional të prokurorëve, duke përfshirë listën e kriterëve relevante si dhe funksionalizohet plotësisht sistemi transparent për mbledhjen e të dhënave homogjene statistikore dhe miratimin dhe implementimin e procedurave në pajtim me standardet e BE-së.
- Krijohet dhe funksionalizohet sistemi disiplinor për gjyqtarë me kriterë dhe masa të qarta disiplinore (duke përfshirë shkarkimin). Krijohen dhe implementohen procedurat disiplinore relevante dhe transparente, duke respektuar plotësisht të drejtat e personit të përfshirë/akuzuar dhe duke respektuar standardet e përgjithshme të shteteve anëtare të BE-së.
- Konsolidohen masat dhe veprimet e mëtutjeshme për implementimin e rekomandimeve dhe arritjeve për emërimin, vlerësimin dhe procedurat disiplinore për prokurorë.

- Zhvillohet kapaciteti i KPK-së, Komisioneve dhe personelit mbështetës si dhe krijohen praktikat e mira për emërimin, vlerësimin dhe procedurat disiplinore për prokurorë.

Komponenti 4: Përmirësimi i Qasjes në Dokumente Ligjore

- Përmes një vlerësimi të nevojave, definohet fushëveprimi dhe roli i një Qendre të Burimeve Ligjore që menaxhohet nga Instituti Gjyqësor i Kosovës. Përmirësohet qasja e gjyqtarëve dhe prokurorëve në dokumente ligjore.
- Në funksion të kësaj nevojitet urgjentisht përsosja e teknikave dhe metodave të komunikimit dhe krijimi i një sistemi qendror shtetëror të dosjeve penale që përmban informata të besueshme për përdorim nga gjyqtarët dhe prokurorët që i përmbush edhe kërkesat për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar.
- Zhvillohet Politika për Sistemin Qendror Shtetëror të Dosjeve Penale dhe krijohet një mekanizëm efektiv i koordinimit.
- Qasja në drejtësi përmirësohet përmes publikimit të të gjitha vendimeve relevante të Këshillave dhe akteve të tjera ligjore dhe krijohet një mekanizëm i bashkëpunimit me akterët relevant të sektorit të drejtësisë (duke përfshirë avokatët, ndërmjetësit dhe noterët).

SFONDI

Në fillim të zbatimit të Projektit, që të dy Këshillat – KGJK dhe KPK – kanë qenë në fazën fillestare të themelimit si organe të veçanta dhe të pavarura sipas ligjeve përkatëse.

Themelimi i dy Këshillave është paraparë në Kushtetutën e Kosovës të 15 Qershorit 2008. Dispozitat përkatëse kushtetuese janë konkretizuar përmes miratimit të dy ligjeve, respektivisht Ligjit Nr. 03/L-223 për KGJK dhe Ligjit Nr. 03/L-224 për KPK të miratuar me 30 Shator 2010.

Para miratimit të këtyre dy ligjeve, sistemi gjyqësor i Kosovës është menaxhuar dhe administruar nga një Këshill i Përbashkët Gjyqësor dhe Prokurorial. Rrjedhimisht, në nivel institucional, KGJK ka pasur përvojë dhe personel mbështetës të përfshirë në funksionimin e organit të përbashkët. Në anën tjetër, KPK ka qenë një organ krejtësisht i ri që ka pasur nevojë për mbështetje në nivel organizativ dhe funksional.

Gjithashtu, para fillimit të reformës në vitin 2011 përmes zbatimit të LKGJK dhe LKPK, autoritetet Kosovare kishin organizuar dhe

zhvilluar një proces të verifikimit dhe ri-emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve që kishe për qëllim kryerjen e një shqyrtimit të përgjithshëm dhe të njehershëm të përshtatshmërisë së të gjithë aplikantëve për emërim të përhershëm si gjyqtar dhe prokurorë në Kosovë. Ky proces është zhvilluar nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial i krijuar posaçërisht për këtë qëllim. Në përfundim të këtij procesi në vitin 2010, një memorandum i mirëkuptimit është nënshkruar mes Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial për transferimin e detyrave, përgjegjësisë dhe asetëve nga KPGJP në KGJK.

Me 1 Janar 2011, pas hyrjes në fuqi të LKGJK dhe LKPK, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës kanë filluar të funksionojnë si institucione të veçanta, të pavarura nga njëri tjetri si dhe nga degët ekzekutive dhe legjislative në ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësisë të tyre. KGJK dhe KPK, si dy institucione të pavarura janë kompetente dhe përgjegjëse për menaxhimin gjithëpërfshirës dhe administrimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Republikën e Kosovës.

Ligji për KGJK përcakton se KGJK-ja është plotësisht e pavarur në ushtrimin e funksioneve të saj për të siguruar që sistemi gjyqësor është i pavarur, i drejtë, i depolitizuar, i qashtëm, profesional dhe i paanshëm dhe që pasqyron multi-etnicitetin e Republikës së Kosovës dhe që zbaton Kushtetutën dhe parimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore. Ky ligj gjithashtu rregullon organizimin dhe funksionimin e Këshillit

Gjyqësor të Kosovës (KGJK) duke përfshirë procedurat e rekrutimit, emërimit, ri-emërimit, transferimit, disiplinës, vlerësimit, ngritjes në pozitë dhe trajnimit të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë; menaxhimin dhe administrimin e gjykatave, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të gjyqësorit; themelimin e gjykatave dhe degëve të reja.

ndërkombëtare dhe mbështetje nga donatorët, përveç aktiviteteve të EULEX për monitorim, mentorim dhe këshillim. Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (tani: Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë) ka vendosur që të mbështesë KGJK dhe KPK përmes një Projekti në kornizën e Instrumentit për Programin e Para-Anëtarësimit.

Ligji për KPK përcakton se Këshilli është institucion plotësisht i pavarur që ushtron funksionet e tij për të siguruar një sistem prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm dhe që pasqyron multi-etnicitetin e Kosovës dhe parimet e pranuar ndërkombëtare për barazinë gjinore.

Ligjet tjera të miratuara në të njëjtën periudhë kohore që janë kyçe për KGJK dhe KPK janë **Ligji Nr. 03/L-199** për Gjykatat miratuar me **22 Korrik 2010** dhe Ligji **Nr. 03/L-225** për Prokurorin e Shtetit, miratuar me **30 Shtator 2010**. Të dyja këto ligje kanë hyrë në fuqi me 1 Janar 2013. KGJK dhe KPK kanë qenë përgjegjëse për organizimin dhe zhvillimin e tranzicionit nga struktura ekzistuese në strukturën e re. Ristrukturimi i gjykatave sipas ligjit të ri përfshin zëvendësimin e gjykatave komunale me gjykatat themelore dhe të pesë (5) gjykatave të qarkut në një gjykatë të vetme të apelit. Ristrukturimi i prokurorive është paraparë në LPSH.

MD ka përgatitur një dokument në Prill 2011 në të cilin ka listuar prioritetet për periudhën 2011-2014, dhe që identifikon gjashtë çështje kryesore, si vijon: koordinimin e sistemit të drejtësisë (bashkëpunimin e plotë me Këshillat është paraparë, për zhvillimin e punës së tyre), iniciativat legjislative (p.sh ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, kodi penal dhe kodi i procedurës penale, ligji për detyrimet, etj.), funksionimi dhe strukturimi i gjykatave dhe prokurorive (që i referohet ristrukturimit të sistemit të përgjithshëm gjyqësor të shpjeguar më lartë, duke respektuar plotësisht pavarësinë e KGJK/KPK).

Sa i përket zbatimit të ligjeve të reja të miratuara në vitin 2010, KGJK dhe KPK kanë pasur nevojë për mbështetje/këshilla

KONTRIBUTET KRYESORE TË PROJEKTIT PËR ZHVILLIMIN E KËSHILLAVE–SIPAS VITEVE

Përmbledhja e Projektit në vijim **është ndarë sipas viteve** dhe ka për qëllim që të theksojë fushat më të rëndësishme në të cilat ka kontribuar projekti, sipas kronologjisë së aktiviteteve kryesore të projektit. Qëllimi është që të theksohen ato grupe të aktiviteteve që janë zhvilluar sipas planit të projektit, gjetjet e ekspertëve dhe nevojat e Këshillave; dhënia e shpjegimeve përse disa nga aktivitetet duhet të konsiderohen shumë të rëndësishme dhe të theksohen pikat e dobëta dhe arsyet për performancën konkrete të Këshillave gjatë zbatimit të Projektit. Kjo analizë do të lehtësojë kuptimin më të mirë të kontributit të projektit, metodat e komunikimit dhe bashkëpunimit me Këshillat dhe konsistencën e veprimeve të ndërmarra nga Projekti dhe përfituesit.

2012

Pas miratimit të Raportit Fillestar të Projektit në fillim të vitit 2012, Projekti ka filluar zbatimin e aktiviteteve të parapara në planin e projektit.

Duke marrë parasysh rrethanat, kornizën ekzistuese ligjore, pritjet e përfituesve dhe statusin e tyre të ndryshëm organizativ dhe funksional, Projekti ka përcaktuar prioritetet për zbatimin e aktiviteteve.

Zbatimi i të gjitha aktiviteteve ka filluar me analizimin dhe vlerësimin e kornizës ekzistuese ligjore dhe përputhshmërinë me ligjet dhe standardet ndërkombëtare. Është theksuar në një fazë shumë të hershme të zbatimit nga të gjithë ekspertët ndërkombëtarë se korniza e re ligjore për KGJK dhe KPK ka shumë mangësi të cilat duhet të adresohen përmes amendamenteve që duhet të përgatiten për plotësimin e standardeve Evropiane. Rrjedhimisht, disa zbrazëtira dhe mospërputhshmëri në kornizën ligjore janë analizuar dhe vlerësuar nga ekspertët. Megjithatë, duke marrë parasysh objektivat dhe aktivitetet e Projektit, ekspertët kanë dhënë kontributin e tyre për Këshillat për përmirësimin e akteve nënligjore ekzistuese, hartimin e akteve të reja nënligjore, zhvillimin e PSV-ve dhe rekomandimin e disa veprimeve dhe masave për zhvillimin e kapaciteteve organizative dhe funksionale të Këshillave.

Aktivitetet në vijim të zhvilluara nga Projekti në vitin 2012 duhet të konsiderohen si aktivitetet më të rëndësishme për Këshillat:

Rregullorja për Organizimin dhe Veprimtarinë e KGJK është shqyrtuar, analizuar dhe vlerësuar

nga Projekti. Pas rekomandimeve të ekspertëve të projektit, KGJK ka miratuar ndryshimet dhe plotësimet në këtë Rregullore me 2 Nëntor, 2012.

Sipas propozimit të Projektit, **Përshkrimet e Detyrave të Punës për KGJK/KPK** sipas formatit të ri janë hartuar dhe pranuar nga dy Këshillat dhe janë propozuar për miratim përfundimtar. Të dy këshillat gjithashtu kanë aprovuar organogramet e Këshillave të përgatitura nga Projekti.

Projekti ka përgatitur dhe dorëzuar tek dy Këshillat një Raport për Vlerësimin e Rregullave dhe Rregulloreve Ekzistuese për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në KGJK dhe KPK, të përgatitur nga ekspertët, që ka për qëllim **zhvillimin e metodologjisë për planifikimin e personelit** për të dy Këshillat dhe shmangien e kufizimeve të kapaciteteve në të ardhmen.

Projekti ka mbështetur dy Këshillat, përmes analizimit dhe rekomandimit të standardeve dhe praktikave të mira Evropiane për **Planifikimin Strategjik Institucional**. Projekti ka përgatitur dhe dorëzuar tek të **dy Këshillat** një **Dokument për Planifikim Strategjik** dhe një Raport Përfundimtar me rekomandime për hartimin e Planit Strategjik. Ky ka qenë dokumenti i parë kyç që u është shpërndarë Këshillave dhe është përdorur nga partnerët vendor dhe ndërkombëtar gjatë përgatitjes së Planeve Strategjike të KGJK dhe KPK.

Pas kërkesës nga KPK, Projekti ka përgatitur komente dhe rekomandime në **Draft Planin Strategjik të KPK për Bashkëpunim Ndër-Institucional për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar**. Kontributi i projektit në këtë aktivitet konsiston në identifikimin e standardeve të aplikueshme ndërkombëtare për draft Planin Strategjik, si dhe në formulimin e objektivave dhe strukturës së draft planit.

Projekti ka analizuar **Rregulloret Ekzistuese të Këshillave** për emërimin, transferimin, ngritjen në detyrë, vlerësimin e performancës dhe procedurat disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë dhe ka dorëzuar tek Këshillat raporte dhe komente, me rekomandime konkrete, për

përmirësimin e këtyre rregulloreve. Shqetësimet kryesore lidhur me rregulloret mund të përmbliidhen në grupe, si vijon:

- Draft rregulloret dhe rregulloret ekzistuese të Këshillave kanë nevojë për shqyrtim sa i përket mënyrës dhe teknikave të hartimit – struktura e akteve nënligjore duhet të përmirësohet, baza ligjore për nxjerrjen e rregulloreve në disa raste ka munguar, ka pasur dispozita në këto akte nënligjore që nuk janë autorizuar sipas ligjeve themelore, në rregulloret, Këshillat kanë përfshirë disa rregulla të cilat duhet të përcaktohen vetëm me ligj, hierarkia e akteve normative nuk është marrë parasysh, etj.;
- Përputhshmëria e rregulloreve me ligjet themelore duhet të sigurohet;
- Të dy Këshillat kanë pasur nevojë për zhvillim të kapaciteteve për hartimin e rregulloreve.

Këto çështje, disa nga të cilat vazhdojnë të jenë sfida për dy Këshillat, gjithashtu janë theksuar në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2015: *“Ende nuk ka mjaft kapacitete për hartimin e rregulloreve dhe marrjen e vendimeve sipas hierarkisë së Akteve normative”*. Lidhur me këtë çështje ende ka nevojë për mbështetje të mëtutjeshme nga partnerët ndërkombëtare.

Zbrazëtirat, kufizimet dhe çështjet në vijim janë sqaruar nga Projekti gjatë vitit të parë të fazës së zbatimit të projektit **lidhur me aktet nënligjore dhe PSV** për emërimin, transferimin, ngritjen në detyrë, vlerësimin e performancës dhe procedurat disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë:

- Rregullorja ekzistuese për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ka pasur nevojë për rishikim të plotë dhe harmonizim me dispozitat e LKGJK, LKPK dhe LIGJK;
- Është zbuluar mungesa e PSV-ve për procedurat e emërimit;
- Transferimi dhe ngritja në detyrë e gjyqtarëve dhe prokurorëve është paraparë nga LKGJK dhe LKPK, megjithatë dispozitat

- ligjore janë të pamjaftueshme për krijimin e një kornize rregullore të pranueshme;
- Rregullorja e KGJK për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve ka qenë në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare, mirëpo ka pasur nevojë për përmirësimin e burimeve të informacionit, indikatorëve të matshëm, krijimin e rregullave të procedurës për Komisionin Vlerësues, PSV-të;
 - KPK nuk ka pasur një sistem adekuat për vlerësimin e performancës së prokurorëve-rrjedhimisht, është kërkuar kontributi i Projektit në hartimin e një Rregullore të re për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, krijimin e një Komisionit Vlerësues, hartimin e PSV-ve përkatëse;
 - Sistemi disiplinor për gjyqtar dhe prokuror në përgjithësi nuk ka qenë në pajtim me standardet ndërkombëtare; disa zbrazëtira ligjore janë analizuar dhe vlerësuar nga projekti si parakusht për një shqyrtim më të thellë të kornizës ligjore për sistemin disiplinor për gjyqtarë dhe prokurorë në pajtim me standardet Evropiane dhe praktikatat e mira;
 - Shqyrtimi dhe ndryshimi i vazhdueshëm i Rregullores së miratuar për Komisionet Disiplinore të Këshillave është vlerësuar si përpjekje për plotësimin e zbrazëtirave dhe diskrepancave në ligjet dhe rregulloret përkatëse. Gjatë diskutimeve për draft ndryshimet dhe plotësimet e këtyre rregulloreve është kuptuar për herë të parë se të dy Këshillat kanë nevojë për mbështetje për përmirësimin e komunikimit dhe harmonizimit të akteve nënligjore ë nevojshme, me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë.

Aktivitetet kryesore të dy Këshillave në vitin 2012 kanë qenë aprovimi i Rregulloreve për caktimin dhe transferimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për zbatimin e këtyre rregullave të reja për të siguruar **kalimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në strukturën e re Gjyqësore dhe Prokuroriale** që

ka hyrë në fuqi me 1 Janar, 2013 (Apelit dhe Themelore). Projekti ka ofruar mbështetje për KPK-në kryesisht përmes dërgimit të komenteve dhe rekomandimeve në Draft Rregulloren e KPK për Caktimin dhe Transferimin e Prokurorëve, rekomandimeve për interpretim dhe zbatimin të Rregullores së miratuar nga Këshilli, Draft Rregullores për Transferim dhe mbështetje të personelit, etj.

Të dy Këshillat e kanë finalizuar këtë proces në mënyrë të suksesshme dhe brenda afateve kohore të përcaktuara në Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit. Nga 1 Janari 2013, të gjithë gjyqtarët, prokurorët dhe personeli mbështetës kanë kaluar në Gjykatat e reja Themelore dhe në Gjykatën e Apelit dhe në Prokuroritë Themelore dhe Prokurorinë e Apelit.

2013

Projekti ka kontribuar në zhvillimin e KGJK-së dhe KPK-së në vitin 2013 në fushat në vijim:

Projekti ka përgatitur një analizë me rekomandime për përmirësimin e **komunikimit ndër-institucional** që pasqyron disa nga praktikatat e mira Evropiane në këtë fushë. Gjatë takimit të përbashkët të KGJK dhe KPK të zhvilluar me 4 Shkurt, 2013, pas rekomandimeve të Projektit, të dy Këshillat kanë vendosur që: të organizojnë një **trajnim të përbashkët** për gjyqtarët dhe prokurorët në trajnim në IGJK; Në bazë të Planit Strategjik të KPK-së për Bashkëpunim Ndër-Institucional për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, KPK dhe KGJK kanë krijuar një **Grup Punues të Përbashkët** për hartimin e një Planit të Veprimit për zbatimin e Planit Strategjik, sqarimin e fushëveprimit të krimeve që duhen klasifikuar si “krime të korrupsionit”, standardizimin e formularëve, shablloneve, aktakuzave, etj. për krim të organizuar dhe korrupsion. Për të siguruar koordinim më të mirë mes dy Këshillave, anëtarët kanë vendosur të zhvillojnë **takime të përbashkëta të Këshillave çdo tre muaj.**

Njëra nga arritjet kryesore gjatë kësaj periudhe ka qenë fakti që Këshillat kanë kuptuar në mënyrë të qartë se pavarësia e dy institucioneve nuk nënkupton domosdoshmëri ndarjen e plotë të të gjitha aktiviteteve. Gjithashtu, pavarësia e institucioneve supozon se ligjet përkatëse duhet të zbatohen në mënyrë të pavarur, mirëpo nëse dispozitat ligjore janë të njëjta për të dy Këshillat, atëherë edhe interpretimit dhe zbatimi i tyre duhet të jetë i njëjtë. Prandaj, **harmonizimi i akteve nënligjore**, të miratuara nga dy Këshillat kur është e nevojshme është definuar në mënyrë të qartë dhe veglat për arritjen e këtij harmonizimi të propozuara nga Projekti janë pranuar.

Në bazë të rekomandimeve të Projektit, KPK ka aprovuar versionin përfundimtar të **Rregullores** për Funksionimin dhe Veprimtarinë e KPK me 4 Mars, 2013 dhe ka themeluar dy Komisione të përhershme – **Komisionin për Çështje Normative dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa**. KPK gjithashtu ka krijuar **Zyrën e re të Trajnimeve** në kuadër të Sekretariatit të KPK dhe ka filluar procesin e hartimit të Planit të ri Vjetor të Trajnimit për prokurorët ushtrues detyrë sipas rekomandimeve të Projektit për të siguruar koordinimit më të mirë në procesin e definimit të nevojave për trajnim të prokurorëve. Këto veprime duhet të konsiderohen si hapa përpara drejt fuqizimit të organizimit të KPK sipas kërkesave ligjore lidhur me funksionimin e Këshillit (Neni. 4, LKPK).

Gjatë kësaj periudhe kohore, Projekti ka mbështetur të dy Këshillat në krijimin e **një kornize të re rregullatore për rekrutimin, përzgjedhjen, nominimin dhe emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve**. Rregulloret ekzistuese të KGJK dhe KPK janë shqyrtuar dhe analizuar, duke marrë parasysh dispozitat relevante ligjore në fuqi.

Ekipi i Projektit ka siguruar harmonizimin e draft amendamenteve në **Rregulloren për Emërimin e Prokurorëve dhe Rregulloren për Emërimin e Gjyqtarëve**. Arsyeja kryesore për këtë është sepse ligjet përkatëse (LKGJK, Ligji për Gjykatat dhe LKPK, Ligji për Prokurorin e Shtetit) përcaktojnë kritere të ngjashme për

vlerësimin e kandidatëve si dhe kërkesa dhe procedura të ngjashme. Në bazë të këtyre raporteve dhe përmes hulumtimit shtesë dhe mbledhjes së informative relevante, Projekti ka përgatitur propozime konkrete për ndryshimin e Rregullores dhe 'paketës' së plotë të Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) si dhe rekomandime të qarta për zbatimin e këtyre PSV-ve.

Shumica e rekomandimeve të Projektit lidhur me **sistemin e emërimit** të gjyqtarëve dhe prokurorëve kanë të bëjnë me ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve. Në përgatitjen e këtyre rekomandimeve është marrë parasysh edhe Katalogu i Rekomandimeve. Disa çështje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave relevante ligjore janë sqaruar, duke përfshirë vlerësimin e përvojës së mëparshme ligjore të kandidatëve, metodën e verifikimit të historikut të kandidatëve, kufizimet për rekrutimin e rregullt të kandidatëve, Programi Fillestar i Trajnimit Ligjor (PFTL), i zhvilluar nga IGJK dhe mungesa e dispozitave ligjore për të marrë parasysh këtë trajnim, si parakusht për emërim, etj.

Sa i përket **sistemit ekzistues të vlerësimit** për gjyqtarë dhe prokurorë, janë ndërmarrë disa hapa të konsiderueshëm nga Këshillat, me mbështetjen e Projektit. Hapi më i rëndësishëm është krijimi i një sistemi të ri të vlerësimit për prokurorët. Një **Rregullore e re për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve dhe rishikimi dhe amendamenti i Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e NJSHPP** janë paraqitur, diskutuar dhe dakorduar me KPK-në. Në këtë mënyrë, vlerësimi i performancës së prokurorëve është harmonizuar me Ligjin për KPK dhe standardet ndërkombëtare. Gjithashtu është bërë i qartë dallimi ndërmjet përgjegjësive të NJSHPP për vlerësimin e prokurorëve dhe KPK-së dhe Komisionit Vlerësues për vlerësimin e performancës së prokurorëve individual. Sa i përket **Rregullores për Vlerësimin e Gjyqtarëve**, KGJK ka aprovuar dy ndryshime dhe plotësime në Rregullore në vitin 2012 sipas rekomandimeve të Projektit. Megjithatë, vlerësimi i ekspertëve të Projektit në atë kohë ka qenë që këto ndryshime dhe plotësime nuk janë të mjaftueshme për harmonizimin e sistemin për vlerësimin e

gjyqtarëve me standardet dhe praktikat e mira Evropiane.

Sistemi disiplinor për gjyqtarë dhe prokurorë është analizuar dhe vlerësuar me shumë kujdes nga Projekti gjatë kësaj periudhe kohore. Të gjitha materialet, komentet, raportet dhe analizat e përgatitura nga Projekti në kuadër të kornizës së aktiviteteve të mëparshme në fushën e hetimeve dhe procedurave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve janë shqyrtuar dhe përmbledhur në një **Raport Përfundimtar Vlerësues** për Procedurat Disiplinore me theks të veçantë në hetimet e ZPD për çështje disiplinore.

Nga Projekti është kërkuar që të mbështesë të dy Këshillat për rritjen e transparencës gjatë zhvillimit të procedurave disiplinore. Kjo është arsyeja që Projekti ka përgatitur dhe dorëzuar në Këshill dokumentet në vijim: Formularin e një **Regjistri** për publikimin e informacionit lidhur me procedurat disiplinore dhe një **Analizë Krahasuese** për çështjen e dëgjimeve publike dhe publikimit të vendimeve nga organet disiplinore. Të dyja dokumentet kanë për qëllim t'i mundësojnë Këshillit që të gjejë zgjidhjen më të mirë për rritjen e transparencës në rastet disiplinore dhe gjetjen e një balance ndërmjet konfidencialitetit dhe transparencës, bazuar në dispozitat ligjore në Kosovë dhe standardet ndërkombëtare.

Vlerësimi i sistemit ekzistues disiplinor në Kosovë dhe bashkëpunimi me programet tjera ndërkombëtare në këtë fushë ka inkurajuar Projektin që të zgjerojë fushëveprimin e detyrave dhe të propozojë zhvillimin e procedurave më të mira disiplinore, duke përfshirë propozimeve për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për KGJK, Ligjit për KPK si dhe një projektligji të ri për rregullimin e punës së ZPD.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar **Zyrës së Prokurorit Disiplinore (ZPD)**. Projekti ka ofruar mbështetje për ZPD, që është përgjegjëse për hetimet disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në bazë të rekomandimeve të Projektit, **ZPD** ka aprovuar **Përshkrimet e reja të Detyrave të**

Punës për personelin e ZPD. Projekti ka hartuar dhe shpërndarë për **ZPD** dhe organet tjera një **Raport Vlerësues për Sistemin Disiplinor për Gjyqtarë dhe Prokurorë**, një analizë krahasuese me disa sisteme të tjera të BE dhe propozime për një **sistem të ri dhe të përmirësuar disiplinor**, duke përfshirë propozimin e një Projektligji të ri për ZPD. Projekti ka dorëzuar në ZPD një 'Shkresë për bazën ligjore për miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e ZPD'

Projekti ka hartuar propozimet për një **PSV të re për hetimet disiplinore** ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe **PSV-të për procedurat disiplinore** bazuar në bazën aktuale ligjore.

Gjatë kësaj periudhe kohore, Projekti ka **përgatitur shtatë Manuale** që përmbajnë udhëzime dhe PSV për procedurat e emërimit, procedurat e vlerësimit dhe disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë (tre manuale për KGJK dhe tre manuale për KPK). Një Manual i veçantë me PSV është përgatitur, përkthyer dhe shpërndarë në ZPD. Të gjitha PSV-të janë përgatitur në pajtim me kornizën ekzistuese ligjore, duke marrë parasysh raportet dhe rekomandimet e Projektit për amendamentet përkatëse në aktet nënligjore.

Manualet kanë shërbyer si materialet kryesore të trajnimit për **aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve** për anëtarët e Këshillave, anëtarët e Komisioneve dhe personelin mbështetës. 'Pilot trajnimet' janë organizuar dhe zhvilluar nga Projekti në fund të vitit 2013 dhe kanë pasur për qëllim zhvillimin e kapaciteteve të personave përgjegjës për emërimin, vlerësimin dhe procedurat disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë. Duhet të theksohet se këto trajnime janë organizuar për herë të parë për të dy Këshillat dhe sekretariatet e tyre përkatëse. Materialet e trajnimit, programet e trajnimit dhe modulet janë përgatitur në atë mënyrë që të mund të përdoren për trajnime të ardhshme nga Këshillat. Gjithashtu, një grup i veçantë i materialeve është siguruar për IGJK, në mënyrë që të përdoren për programet fillestare të trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë.

2014

Në vijim është paraqitur një përmbledhje e fushave më të rëndësishme në të cilat Projekti ka mbështetur KGJK-në dhe KPK-në në vitin 2014:

Burimet dhe përpjekjet kryesore të projektit janë orientuar drejt përgatitjes së një **Katalogu të Rekomandimeve** për organizimin, strukturën, funksionet e Këshillave dhe për emërimin, vlerësimin dhe procedurën disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë. Katalogu është përgatitur në bazë të gjetjeve dhe rekomandimeve të hartuara nga të gjithë ekspertët e projektit gjatë zbatimit të aktiviteteve në kuadër të Komponentit I, Komponentit II dhe Komponentit III. Pas një diskutimi të hollësishëm për Draft Katalogun e parë me KGJK dhe KPK, Projekti ka rishikuar Katalogun dhe ka përfshirë në të referencat në standardet përkatëse ndërkombëtare dhe Evropiane.

Gjithashtu, një **Libër i Referencave** i ri që përmban 22 dokumente ndërkombëtare me standardet përkatëse ndërkombëtare dhe Evropiane që janë përfshirë në Katalogun e Rekomandimeve, është përgatitur nga Projekti, është përkthyer në gjuhën Shqipe dhe është shpërndarë për KGJK, KPK dhe akterët tjerë. Në mënyrë që të lehtësohet përdorimi i këtyre dokumenteve ndërkombëtare, një indeks me më shumë se 200 fjalë kyçe është përgatitur gjithashtu.

Fushat tjera të rëndësishme të mbështetjes së Projektit për dy Këshillat në vitin 2014 kanë qenë lidhur me hartimin e draft amendamenteve ligjore (e ashtuquajtura **“paketa e 4 ligjeve”**) të propozuara nga MD në fillim të vitit 2014. Projekti ka dorëzuar komente dhe ka marrë pjesë në disa takime dhe diskutime për projekt amendamentet ligjore. Gjithashtu, Projekti ka përgatitur dhe dorëzuar Këshillave një **Koncept Dokument** për projekt amendamentet ligjore që trajton çështjen e sistemit të ri të rekrutimit, nominimit dhe emërimit të kandidatëve për gjyqtar dhe

prokurorë. Ky ka qenë dokumenti i parë i politikave të përgatitura nga Projekti në atë kohë dhe gjatë këtij aktiviteti është vërejtur se këshillat kanë nevojë për mbështetje të posaçme në fushën e analizës dhe zhvillimit të politikave.

Një kontribut tjetër i konsiderueshëm i Projektit në vitin 2014 ka pasur të bëjë me përmirësimin e bashkëpunimit mes akterëve kryesor në sistemin gjyqësor në Kosovë që janë përgjegjës për rekrutimin, nominimin, përzgjedhjen, trajnimin fillestar dhe **emërimin** e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë. Projektet e BE-së për mbështetjen e KGJK dhe KPK si dhe IGJK kanë organizuar një diskutim të përbashkët me KGJK, KPK dhe IGJK në Mars 2014 që ka pasur për qëllim sqarimin e arritjeve dhe çështjeve lidhur me sistemin ekzistues të emërimit si dhe prezantimin e modeleve të ndryshme Evropiane për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Aktivitetet e reja të aprovuara të Projektit përmes Shtojcës 2 të Kontratës për Zbatimin e Projektit janë përfunduar në vitin 2014. Dy nga këto aktivitete duhet të konsiderohen si aktivitete kyçe: “mjetet juridike kundër vendimeve të KGJK dhe KPK” dhe “Sistemi Qendror Shtetëror i Dosjeve Penale” (SQSHDP). Në kuadër të aktivitetit të parë, Këshillave u janë siguruar standardet ndërkombëtare lidhur **të drejtën e ankesës ndaj vendimeve të KGJK dhe KPK** para një gjykate të pavarur, një studim krahasimor i praktikave të mira Evropiane dhe rekomandime të qarta lidhur me amendamentet përkatëse ligjore. Projekti ka rekomanduar përfshirjen e këtyre çështjeve në amendamentet ligjore, mirëpo amendamentet e miratuara në LKGJK dhe LKPK në vitin 2015 nuk i kanë marrë parasysh këto rekomandime shumë të rëndësishme. Kjo është arsyeja përse mungesa e dispozitave ligjore që garantojnë të drejtën e ankesës dhe që parashohin një procedurë të shpejtë dhe transparente gjyqësore pranë një gjykate të lartë në Kosovë, siç është Gjykata Supreme, konsiderohet ende si fushë problematike në të cilën kërkohet mbështetje ndërkombëtare dhe iniciativë legjislative. Siç është përcaktuar edhe në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2014: “...Mjetet juridike kundër vendimeve të Këshillit

Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial duhet të parashihen, në mënyrë që të shmangët situata në të cilën e vetmja rrugë është drejtimi në Gjykatën Kushtetuese.”

Në kuadër të një aktiviteti tjetër është mbështetur KGJK në analizimin dhe vlerësimin e kornizës ligjore, kapacitetit dhe aftësive të autoriteteve Kosovare për **themelimin e një SQSHDP**. Në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2014 është theksuar në mënyrë të qartë mungesa e një baze të të dhënave qendrore të dosjeve penale dhe ndikimin negativ që ka mungesa e një data baze të këtyllë në sistemin gjyqësor: “...nuk ekziston një data bazë qendrore e dosjeve penale, që pengon efikasitetin e sistemit gjyqësor.”. Prandaj, vlerësimi dhe analiza e Projektit si dhe propozimet për metodologjinë e krijimit të SQDP kanë qene shumë të rëndësishme dhe të dobishme për sistemin gjyqësor dhe shoqërisë civile në Kosovë, në përgjithësi.

Gjatë vitit 2014, të dy **Këshillat** janë ballafaquar me **situata të ndryshme dhe sfiduese**: Vendimi i **KPK** për propozimin e emërimit të **Kryeprokurorit të ri të Shtetit** është hedhur poshtë me vendim të Gjykatës Kushtetuese me 8 Korrik 2014. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese përmban një arsyetim shumë të qartë që është shqyrtuar me kujdes nga KPK. Gjithashtu, kjo ka qenë hera e parë pas krijimit të dy Këshillave në të cilën pavarësia e tyre është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese nga perspektiva e parimit të sundimit të ligjit dhe shkeljes së të drejtave kushtetuese të kandidatëve. I tërë procesi i emërimit dhe përzgjedhjes së një Kryeprokurori të ri është përsëritur dhe ka rezultuar në një periudhë kohore në të cilën ka pasur një Kryeprokuror të Përkohshëm të Shtetit. Me 30 Korrik është emëruar një ‘Ushtrues Detyre i Kryeprokurorit të Shtetit’, megjithëse ka munguar baza ligjore për një emërim të tillë. Përsëritja e procesit të përzgjedhjes dhe emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit ka marrë kohë të konsiderueshme dhe ka çrregulluar pjesërisht funksionimin normal të Këshillit.

KGJK nuk ka qenë në gjendje që të arrijë kuorumin minimal të nevojshëm për vendimmarrje pas pensionimit të njërit nga

anëtarët nga Komuniteti Serb dhe skadimit të mandatit të dy anëtarëve ndërkombëtar nga Gushti 2014 deri në Shkurt 2015. Këto pozita është dashur të plotësohen nga Kuvendi, që është konstituuar në Dhjetor 2014 pas zgjedhjeve të mbajtura në Qershor 2014. Për këtë arsye, funksionimi normal i KGJK është penguar për disa muaj. Ka qenë e nevojshme që Projekti t’ua përkujtojë autoriteteve Kosovare edhe një herë rekomandimin që rrjedh nga standardet ndërkombëtare sipas të cilit më shumë se 50% e anëtarëve të këshillave gjyqësor duhet të zgjedhën nga kolegët e tyre. Megjithatë, ky ndryshim kërkon amendamente Kushtetuese. I njëjti koment është dhënë edhe në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2014: “Shumica e anëtarëve të këshillit gjyqësor duhet të zgjedhën nga kolegët e tyre, sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecias.” Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi ndryshim-plotësimin përkatës të Nenit 108(6) të Kushtetutës me 24 Shkurt 2016. Mbështetur në këtë ndryshim-plotësim, shtatë nga trembëdhjetë anëtarët e KGJK-së ‘do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit’. Kështu, rekomandimi i Projektit është implementuar dhe zgjedhja e anëtarëve të KGJK tashmë është në përputhshmëri me standardet Ndërkombëtare

Projekti ka **përfunduar** me kohë të gjitha dyzet e pesë (45) aktivitete të parashikuara në planin tre vjeçar të projektit në Shtator 2014. Vazhdimi i Projektit për një periudhë shtesë 18 mujore për zbatimin e njëzet e tri (23) aktiviteteve shtesë është aprovuar në Tetor 2014. Prandaj, Faza e dytë e Zbatimit të Projektit (vazhdimi) ka filluar në Tetor 2014.

2015

Fushat më të rëndësishme të mbështetjes së Projektit për KGJK dhe KPK në vitin 2015 kanë pasur të bëjnë me interpretimin dhe implementimin e **amendamenteve ligjore** të katër ligjeve (LKGJK, LKPK, LGJ dhe LPSH) që janë miratuar nga Kuvendi me 28 Maj, 2015.

Ndryshimi dhe plotësimi i katër ligjeve të lidhura me pushtetin gjyqësor, është kërkuar në

Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, të vitit 2014. Në këtë Raport, ndër rekomandime të tjera, është theksuar se ligjet duhet të harmonizohen në mënyrë që të adresojnë mungesën e përputhshmërisë lidhur me çështje të ndryshme siç është shkarkimi, emërimi, transferimi, sistemi disiplinor dhe procedurat për shqyrtimin e vendimeve të marra nga Këshillat. Raporti i Progresit gjithashtu thekson se duhet të bëhet më shumë për të siguruar funksionimin efektiv dhe llogaridhënien e gjyqësorit.

Në kuadër të Konkludimeve të Komisionit Sektorial për Drejtësi, Liri dhe Siguri, që është pjesë e dialogut të Stabilizim Asocimit ndërmjet BE dhe Kosovës, të zhvilluar në muajin Janar në Bruksel dhe në seancën e pestë plenare të procesit të dialogut të Stabilizim Asocimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës të zhvilluar në Korrik 2015. Dialogu gjithashtu ka theksuar nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e këtyre ligjeve për të përmirësuar funksionimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë.

Kontributi i Projektit në këtë çështje duhet të ndahet në dy faza: Komentet në draft amendamentet ligjore janë shpërndarë nga Zyra e BE-së në Kosovë në Mars 2015 dhe Maj 2015 dhe mbështetja për Këshillat pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të amendamenteve ligjore.

Duhet të theksohet se Projekti nuk ka qenë i përfshirë në takimet e grupeve punuese të MD, në të cilat janë diskutuar dhe hartuar amendamentet ligjore. Kontributi i Projektit është kërkuar nga Zyra e BE në Kosovë, Mekanizimi për Shqyrtimin e Ligjeve (MSHL) pasi MD kishte dorëzuar draftin final të amendamenteve ligjore. Gjithashtu duhet të theksohet se disa nga amendamentet ligjore kanë qenë në përputhje me rekomandimet e Projektit dhe standardet ndërkombëtare.

Disa nga dispozitat e propozuara si pjesë e amendamenteve janë të paqarta dhe problematike nga pikëpamja e interpretimit. Janë gjithashtu edhe disa fusha kyçe në të cilat ende ka nevojë për amendamente ligjore

shtesë në mënyrë që të plotësohen standardet ndërkombëtare, siç është rasti në çështjen e sistemit disiplinor për gjyqtarë dhe prokurorë. Mungesa e dispozitave kalimtare ka shkaktuar disa pengesa dhe çështje për organet gjyqësore në fillim të zbatimit të amendamenteve të reja ligjore. Projektligji për Akademinë Gjyqësore të Kosovës (AGJK) gjithashtu është dashur të përfshihet në paketën e ligjeve të ndryshuara në vitin 2015, duke qenë se procedurat e emërimit të Këshillave dhe procedurat e vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë emërimit fillestar prej tri viteve janë ngushtë të ndërlidhura me trajnimin fillestar që është në kuadër të kompetencave të IGJK (AGJK). Harmonizimi i mëtutjeshëm i ligjeve rekomandohet fuqishëm. Gjithashtu, janë edhe disa rregullore të Këshillave që varen nga miratimi i LAGJK dhe hartimi dhe miratimi i tyre duhet të shtyhet deri në miratimin e LAGJK.

Gjithashtu ka edhe amendamente të konsiderueshme në ligjet themelore të sistemit gjyqësor në Kosovë të cilat duhet të analizohet dhe të nxirret një interpretim identik për dispozitat e njëjta në ligjet e të dy Këshillave. Amendamentet më substanciale kanë të bëjnë me sistemin e emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përcaktimin e një përbërje të re të KPK dhe një Sekretariat të veçantë të KPK për ofrimin e mbështetjes së veçantë për KPK për zbatimin e dispozitave përkatëse ligjore.

Sido që të jetë, amendamentet ligjore të miratuara në vitin 2015 duhet të konsiderohen si një hap pozitiv legjislativ përpara.

Të dy Këshillat kanë pranuar mbështetje aktive në zbatimin e **Planeve të Veprimit** të aprovuara nga KGJK dhe KPK për hartimin dhe miratimin e Rregulloreve të parashikuara në amendamentet ligjore. Planet e Veprimit kanë qenë në përputhje me gjetjet e Raportit të Fundit të Progresit për Kosovën për vitin 2015: *“KGJK dhe KPK kanë pasur vonesa të konsiderueshme në aprovimin e dokumenteve strategjike, rregulloreve dhe vendimeve ose Akteve të tjera.”*

Projekti ka marrë pjesë në takimet e Grupeve Punuese të Këshillave dhe në takimet e

Komisioneve për Aktet Normative, ku ka dhënë komente dhe rekomandime për draft rregulloret përkatëse, ka marrë pjesë në Punëtori të organizuara nga Këshillat dhe gjithashtu ka zhvilluar punëtori për KGJK, KPK, Sekretariatet e Këshillave dhe akterët ndërkombëtar për hartimin dhe përmirësimin e draft rregulloreve. Projekti i ka kushtuar vëmendje të veçantë harmonizimit të akteve nënligjore të dy Këshillave në rastet kur amendamentet ligjore në ligjet përkatëse janë të njëjta dhe kërkojnë interpretimin e njëjtë dhe qasjen e njëjtë ose të ngjashme në krijimin e rregullave procedurale. Prandaj, në fillim të vitit 2016, të dy Këshillat tashmë kanë miratuar disa nga Rregulloret më të rëndësishme të parapara në amendamentet ligjore. Disa nga ato janë ende drafte, mirëpo Projekti ka dorëzuar komente dhe propozime lidhur me këto draft rregullore që duhet të merren parasysh gjatë procesit të miratimit nga Këshillat.

Një fushë tjetër kyçe në të cilën ka kontribuar Projekti për zhvillimin e këshillave në vitin 2015 dhe në fillim të vitit 2016 ka qenë zhvillimi i kapaciteteve të këshillave për përgatitjen, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e **Planeve Strategjike**. Projekti ka siguruar për KGJK një vegël të Monitorimit dhe Vlerësimit dhe ka zhvilluar një punëtori për trajnimin e Këshillave për mënyrën e përdorimit të veglës dhe si të bëhet vlerësimi i rregullt, transparent dhe i dobishëm i zbatimit të Planit të Veprimit për Zbatimin e Planit Strategjik të KGJK të miratuar në vitin 2014. Sa i përket KPK, Projekti ka përgatitur dhe dorëzuar në Këshill një draft Plan Strategjik 3 vjeçar për KPK, një draft Plan të Veprimit dhe draft Planin e Monitorimit dhe Vlerësimit. Versioni i fundit i Planit Strategjik të KPK është shqyrtuar dhe ndryshuar nga Projekti në mënyrë që të përshtatet me ndryshimet e fundit ligjore dhe objektivat strategjike. Gjatë përgatitjes së këtyre dokumenteve, Projekti ka organizuar disa takime koordinuese me projekte dhe programe tjera ndërkombëtare.

KPK ka aprovuar **Planin e Parë Strategjik 3 Vjeçar në Shkurt 2016**. Që nga fillimi, Projekti e ka mbështetur plotësisht KPK-në për përgatitjen e planit strategjik. Përgatitja e planit strategjik

ka marrë kohë për shkak të mungesës së kapaciteteve të Këshillit për hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për zbatimin e Planit Strategjik. Projekti ka rekomanduar që KPK të krijojë një njësi të posaçme në Sekretariatin e sapo themeluar të KPK që do të ishte përgjegjëse për planifikim strategjik dhe për raportim në Këshill. Në këtë mënyrë do të mund të bëhej specializimi i ekspertëve të rinj të emëruar në këtë Njësi për ushtrimin e këtij funksioni të rëndësishëm të Këshillit. Pas aprovimit të Planit Strategjik është adresuar edhe njëri nga rekomandimet e Raportit të Progresit për Kosovën për vitin 2015 në të cilin është theksuar vonesa në aprovimin e dokumenteve strategjike nga KPK. Këshilli ka nevojë për mbështetje të mëtutjeshme për finalizimin, aprovimin dhe zbatimin adekuat të Planit të Veprimit dhe Planit të Monitorimit dhe Vlerësimit.

Një fushë tjetër kyçe në të cilën ka kontribuar Projekti për zhvillimin e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillave përfshin **analizën e politikave dhe përgatitjen e koncept dokumenteve**. Projekti ka dorëzuar në KGJK dhe KPK disa koncept dokumente për aktivitetet përkatëse. Një **program specifik i trajnimit** për zhvillimin e kapaciteteve të Këshillave në analizën dhe zhvillimin e politikave është përgatitur nga Projekti, është trajnimi është realizuar nga Projekti. Një **Koncept Dokument për Projektligjin për ZPD** është përgatitur bashkërisht nga Projekti, MD, ZPD dhe përfaqësues nga Ambasada e SHBA, DD.

Projekti u ka dorëzuar Këshillave një **Manual Gjithëpërfshirës për Buxhetimin në Gjyqësor** që do të shërbejë si vegël e rëndësishme për përmirësimin e mëtutjeshëm të planifikimit, raportimit dhe decentralizimit të buxhetit. Projekti konstaton se Këshillat kanë nevojë për mbështetje të mëtutjeshme nga komuniteti ndërkombëtar për përmirësimin e procesit të

buxhetimit për sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Në vitin 2015, Projekti i ka kushtuar vëmendje të veçantë zhvillimit të kapaciteteve të dy Këshillave lidhur me **procesin e vendimmarrjes**, koordinimin e brendshëm të Këshillave, krijimin e një mekanizmi për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të vendimeve të Këshillave. Këshillat kanë nevojë për mbështetje shtesë në këtë drejtim, duke përfshirë përmes zhvillimit të kapaciteteve të anëtarëve të Këshillave dhe personelit mbështetës. Kjo çështje është theksuar në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2015, si vijon: *“Ka mungesë të kapaciteteve brenda KGJK dhe KPK për monitorimin e zbatimit të vendimeve të tyre.”*

Një fushë tjetër e rëndësishme në të cilën është angazhuar Projekti gjatë vitit 2015 ka qenë në **aktivitetet për zhvillimin e kapaciteteve** të organizuara dhe realizuara nga ekspertët. Janë zhvilluar disa punëtori, tryeza të rrumbullakëta dhe seminare për aktivitetet përkatëse. Të gjitha kanë pasur për qëllim zhvillimin e kapaciteteve të personave përkatës – anëtarëve të Këshillave, Kryetarëve të Gjykatave, Kryeprokurorëve, personelit mbështetës, për përmbushjen e detyrimeve të tyre dhe funksioneve sipas ligjeve, akteve nënligjore dhe PSV-ve të miratuara nga Këshillat.

Në fund, duhet të theksojmë aktivitetet e realizuara lidhur me zhvillimin e **Sistemit Qendror Shtetëror të Dosjeve Penale** (SQSHDP). Kjo është njëra nga fushat më të rëndësishme në të cilën ka nevojë për mbështetje të mëtutjeshme për KGJK dhe Gjykatat. Konkludimet kryesore lidhur me zhvillimin e SQSHDP janë përfshirë në pjesën e ardhshme të këtij publikimi.

Projekti i ka **përfunduar** me kohë të gjitha njëzet e tri (23) aktivitetet e parapara për tu përfunduar në fazën e dytë të implementimit (vazhdimin 18 muajor të Projektit) në Mars 2016.

VLERËSIMI I MBËSHTETJES SË PROJEKTIT SIPAS FUSHAVE, REZULTATET E ARRITURA DHE ASPEKTET KYCE PËR ZHVILLIMIN E MËTUTJESHËM TË KËSHILLAVE

VLERËSIMI SIPAS FUSHAVE

Në këtë pjesë është bërë një përmbledhje e kontributeve më të rëndësishme të Projektit në fushën e organizimit dhe funksionimit të Këshillave, procedurat e emërimit, transferimit, ngritjes në detyrë, vlerësimit të performancës dhe procedurat disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe përmirësimet tjera për rritjen e qasjes në drejtësi. Kjo pjesë përmban **rekomandimet më të rëndësishme të Projektit në 'fushat kyçe'** të cilave duhet tu kushtohet vëmendje e veçantë si dhe mbështetje shtesë ndërkombëtare për Këshillat për arritjen e rezultateve më të mira në zhvillimin e menaxhimit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, zhvillimin e kapaciteteve të Këshillave dhe rritjen e besimit publik në sistemin gjyqësor. Qëllimi është që të lehtësohen përpjekjet e autoriteteve vendore dhe institucioneve Evropiane në

përpjekjet e vazhdueshme për zhvillimin e një sistemi transparent, të qëndrueshëm dhe efektiv gjyqësor.

Kjo pjesë përmban një vlerësim të shkurtër të ndikimit të gjetjeve më të rëndësishme, propozimeve dhe rekomandimeve në fushat përkatëse. **Përmbajtja e** kontributeve kryesore të Projektit dhe **pasojat e** rekomandimeve më të rëndësishme të Projektit janë përmbledhur përshtatshëm. Status *quo* e shkallës së implementimit të rekomandimeve më të rëndësishme të ndara sipas fushave dhe arritjen e Projektit të planifikuara në fillim të implementimit të Projektit, gjithashtu janë paraqitur në këtë pjesë të publikimit.

Në këtë pjesë, theksi është vënë në sfidat e reja para Këshillave dhe qëndrueshmërinë e produkteve të Projektit.

Zhvillimi organizativ dhe funksional i KGJK dhe KPK

Zhvillimi organizativ dhe funksional i dy Këshillave është mbështetur nga Projekti përmes implementimit të të gjitha aktiviteteve të parapara në Komponentin I. Aktivitetet e implementuara në kuadër të Komponentit I janë të ndryshme dhe është e pamundshme që të pasqyrohen të gjitha aktivitetet e zhvilluara në këtë publikim. Kjo është arsyeja që vetëm gjetjet kryesore, rekomandimet e përgjithshme më të rëndësishme dhe rekomandimet e reja relevante lidhur me zhvillimin e kapaciteteve të këshillave dhe kapaciteteve të tyre organizative

dhe funksionale janë përmbledhur për vëmendjen e Këshillave dhe akterëve të tjerë. Amendamentet ligjore në LKGJK dhe LKPK të miratuara me 28 Maj 2015 tashmë kanë shtuar disa dispozita shumë të rëndësishme që duhet të konsiderohen si hap përpara në implementimin e standardeve ndërkombëtare dhe rekomandimeve të Projektit lidhur me organizimin, funksionimin dhe përbërjen e Këshillit. Funksionet e reja të Këshillave, posaçërisht mundësia për nxjerrjen e rregulloreve të Këshillave dhe afatet për nxjerrjen e tyre si dhe përbërja e re e KPK pa anëtarësinë e Ministrisë të Drejtësisë, zgjedhja e 9 nga 13 anëtarët e KPK-së nga prokurorët, krijimi i një Sekretariati të posaçëm të KPK, përcaktimi i Komisioneve të Përhershme të Këshillave, kriteret e reja për dhe kërkesat për anëtarët e Komisioneve, etj., duhet të konsiderohen si dispozita që janë në përputhje me rekomandimet e Projektit.

Nga pikëpamja e legjislacionit primar duhet të theksohet se janë ende disa fusha në të cilat ka nevojë për ndryshime dhe **plotësime** në mënyrë që të harmonizohen me kornizën ligjore të Kosovës dhe standardet Evropiane në mënyrën më të mirë të mundshme. ‘Paketa’ e rekomandimeve të Projektit për rishikimin e plotë të sistemit disiplinor për gjyqtarët dhe prokurorët është në dispozicion për shqyrtim gjatë zhvillimit të iniciativave të ardhshme legjislative

Rekomandimi i Projektit lidhur me standardet ndërkombëtare sipas të cilave së paku 50% e anëtarëve të Këshillave të zgjedhën nga kolegët e tyre gjyqtar është implementuar së fundi përmes miratimit të amendamenteve të nenit 108(6) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës me 24 Shkurt 2016. ..

Nga pikëpamja e legjislacionit sekondar duhet të theksohet se të dy Këshillat kanë përgatitur Planet e Veprimit për hartimin, rishikimin dhe aprovimin e Rregulloreve përkatëse të parapara në amendamentet ligjore të vitit 2015. Përpyekjet kryesore të Këshillave dhe ekspertëve dhe këshilltarëve ndërkombëtare kanë qenë të orientuara drejt implementimit të Planeve të Veprimit. Duhet të theksohet se të

dy Këshillat ende kanë disa rregullore të cilat duhet të rishikohen dhe disa rregullore të reja të cilat duhet të miratohen. Partnerët ndërkombëtar duhet të vazhdojnë të mbështesin Këshillat dhe Komisionet e tyre për Akte Normative në këtë drejtim.

Megjithatë, gjatë përgatitjes dhe diskutimit të draft rregulloreve me anëtarët e grupeve punuese të KGJK dhe KPK dhe anëtarët e Komisioneve të tyre për Akte Normative është konkluduar se Këshillat tashmë i kanë zhvilluar kapacitetet e tyre për hartimin e akteve nënligjore. Kontributi i Projektit në përmirësimin e kapaciteteve të Këshillave për hartimin dhe zbatimin e akteve nënligjore gjatë tërë kohëzgjatjes së Projektit ka qenë esencial dhe shumë i vlerësuar.

Implementimi i amendamenteve ligjore dhe Rregulloreve të reja të miratuara nga dy Këshillat si dhe zgjedhja e anëtarëve të rinj të Këshillave kërkon organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve.

Për funksionalizimin praktik të Sekretariatit të KPK ende kërkohet ndërmarrja e disa masave nga KPK, siç është zhvillimi i një politike adekuate të BNJ, duke përfshirë analizën dhe vlerësimin e potencialit ekzistues, aprovimin e një Rregullore të re për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit dhe një Organogram të Sekretariatit nga Këshilli, rishikimin e përshkrimeve të detyrave të punës, përgatitjen e Përshkrimeve të reja të Detyrave të Punës, dallimin e qartë të përgjegjësisë të personelit mbështetës, etj. Përmeshja e këtyre detyrave të veçanta kërkon mbështetje të mëtutjeshme. Të gjitha rekomandimet dhe propozimet e Projektit të përgatitura para miratimit të amendamenteve ligjore që ndërlidhen me funksionet dhe organizimin e Sekretariateve të Këshillave dhe nuk janë në konflikt me dispozitat e reja ligjore janë të aplikueshme.

Plani Strategjik tre vjeçar i KPK i sapo miratuar është përgatitur kryesisht nga Projekti dhe është ndryshuar disa herë me kërkesë të përfituesve. KPK-së i është dorëzuar nga

Projekti një draft Plan i veprimit dhe një Draft Plan i Monitorimit dhe Vlerësimit. Të dyja këto dokumente duhet të analizohen dhe aprovohen nga Këshilli. Në këtë mënyrë, implementimi i Planit Strategjik duhet të bëhet përshtatshëmish nga KPK.

Projekti gjithashtu ka dorëzuar në KGJK një Plan për Monitorim dhe Vlerësim dhe një Vegël për implementimin e Planit Strategjik pesë vjeçar të miratuar nga KGJK në vitin 2014. KGJK ka ndërmarrë masat përkatëse për implementimin e rekomandimeve të Projektit në këtë drejtim. Procesi duhet të monitorohet dhe kontrollohet vazhdimisht.

Koordinimi ndërmjet implementimit të Planeve Strategjike dhe Planeve Vjetore të Këshillave duhet të sigurohet nga Këshillat.

Analiza e politikave nga Këshillat në dy vitet e fundit ka qenë fushë prioritare për Projektin. Duke u bazuar në aktivitetet e projektit të zhvilluara, dokumentet e përgatitura nga Projekti dhe të shpërndara për Këshillat dhe në veçanti trajnimin e caktuar për hartimin e politikave, duhet të konkludohet se kapacitetet e Këshillave në këtë fushë janë zhvilluar dhe se Këshillat mund të zhvillojnë kapacitetet e tyre vetvetiu në këtë fushë.

Koncepti Dokumenti për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve i përgatitur nga Projekti është njëri nga dokumentet më të rëndësishme që paraqet kornizën e politikave të Këshillave lidhur me trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm. Disa fusha të kësaj politike duhet të zhvillohen përmirësohen dhe sqarohen më tutje pas miratimit të Ligjit për AGJK. Rekomandohet që ky dokument të përdoret gjatë hartimit të rregulloreve përkatëse për trajnime, PSV dhe për trajnimin e personave që janë përgjegjës për trajnime.

Projekti u ka siguruar të dy Këshillave analiza dhe rekomandime për zhvillimin e **buxhetimit** të në sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Mekanizmat e planifikimit dhe raportimit në fushën e buxhetimit janë përgatitur dhe u janë dorëzuar përfituesve. Është propozuar një qasje strategjike për decentralizimin e buxhetit dhe është propozuar dhe diskutuar me personat përgjegjës për buxhetim në kuadër të dy

Këshillave. Një manual për buxhetimin dhe të gjitha materialet dhe udhëzimet për implementimin e programit kompjuterik të posaçëm dhe programit të trajnimit është shpërndarë për përfituesit. Rekomandohet që Komisionet për Buxhet të Këshillave të përcaktojnë organizimin e rregullt për zbatimin e metodave dhe mjeteve të përfshira në Manualin e Projektit si dhe për zhvillimin e trajnimeve.

Koordinimi i dy Këshillave në këtë fazë duhet të vlerësohet shumë pozitivisht. Në krahasim me vitet e mëparshme kur një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve të Projektit janë orientuar në përmirësimin e koordinimit dhe bashkëpunimit mes Këshillave, tashmë është evident fakti që Këshillat janë duke e iniciuar dhe menaxhuar këtë proces në mënyrë shumë të pavarur dhe të mirë.

Ende ka disa pengesa në krijimin e bashkëpunimit dhe **komunikimit të mirëfilltë me IGJK (AGJK)** kryesisht për shkak se LAGJK ende nuk është miratuar. Është me rëndësi të veçantë që Këshillat dhe Akademia Gjyqësore e Kosovës të krijojnë një mekanizëm të qartë të bashkëpunimit për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve pas miratimit të LAGJK. Kontributi i Projektit në këtë drejtim mund të sigurohet përmes analizave, koncept dokumenteve dhe rekomandimeve tashmë të dorëzuara në të dy Këshillat.

Bashkëpunimi ndërmjet KGJK dhe Kryetarëve të Gjykatave dhe ndërmjet KPK dhe Kryeprokurorëve ka nevojë për përmirësim të mëtutjeshëm. Çështjet e prezantuara në raportet vjetore të Kryetarëve të Gjykatave dhe Kryeprokurorëve duhet të pasqyrohen në vendimet e Këshillave. Kjo do të thotë se prezantimi i raporteve vjetore nga Kryetarët e Gjykatave dhe Kryeprokurorët janë hapat e parë në tërë procesin e menaxhimit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Masat përkatëse në fushëveprimin e kompetencave të këshillave, për përmirësimin e organizimit dhe funksionimit të secilës gjykatë dhe prokurori, duhet të shqyrtohen nga vetë Këshillat. Gjithashtu, zbatimi i këtyre masave duhet të kontrollohet nga Këshillat dhe të raportohet në takimet e Këshillave.

Zhvillimi i kapaciteteve të anëtarëve të Këshillave dhe personelit mbështetës për trajnimeve dhe diskutimeve të përbashkëta duhet të vazhdojë me mbështetjen e programeve dhe projekteve të donatorëve

ndërkombëtarë. Materialet e trajnimit të Projektit, duke përfshirë programet e trajnimit, analizat e nevojave të trajnimit, raportet vlerësuese për trajnime janë në dispozicion si shtojca të Raportit Përfundimtar.

Rezultatet e arritura lidhur me zhvillimin organizativ dhe funksional të KGJK dhe KPK

- ✓ Ndryshim-plotësimi Kushtetues i Nenit 108(6) i hyrë në fuqi me 24 Shkurt 2016 dhe amendamentimet e LKPK të hyra në fuqi me 15 Korrik 2015 theksojnë së më shumë së 50% anëtarëve të KGJK dhe KPK do të jenë gjyqtarë, respektivisht prokurorë të zgjedhur nga kolegët e tyre. Kështu, janë implementuar rekomandimet e projektit në këtë drejtim që synojnë të prezantojnë standardet ndërkombëtare dhe që synojnë të mbështesin Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial në krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, të drejtë, të qasshëm, profesional dhe të paanshëm në Kosovë.
- ✓ Kapaciteti i anëtarëve të KGJK dhe KPK dhe personelit mbështetës të Këshillave për hartimin, interpretimin dhe implementimin e rregulloreve të kërkuara në Ligjet përkatëse, është zhvilluar dhe rregulloret e reja të miratuara janë dëshmi për zhvillimin e këtyre kapaciteteve; Projekti u ka ofruar Këshillave mbështetje të plotë për hartimin, shqyrtimin, komentimin dhe rishikimin e akteve nënligjore, për të siguruar përputhshmërinë e akteve nënligjore me ligjet përkatëse dhe për të lehtësuar implementimin e këtyre akteve nënligjore;
- ✓ Të dy Këshillat tashmë kanë arritur rezultate shumë të mira në planifikimin e punës së Këshillave; Projekti ka siguruar për Këshillat draft dokumente strategjike, duke përfshirë vegla të Monitorimit dhe Vlerësimit; Këshillat i kanë aprovuar planet e tyre strategjike dhe kanë krijuar mekanizmat e nevojshëm për implementimin e rregullt si dhe vlerësimin e planeve strategjike;
- ✓ Politikat dhe standardet për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve janë shtjelluar nga Projekti dhe të dy Këshillat tashmë kanë një vizion të qartë për implementimin e mëtutjeshëm të këtyre dokumenteve të politikave për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- ✓ Projekti ka ofruar për dy Këshillat dhe për personat përgjegjës për buxhetin brenda Këshillave një Manual dhe trajnime të veçanta për zhvillimin e kapaciteteve të tyre për planifikimin, implementimin dhe raportimin e buxhetit të sistemit gjyqësor; Të dy Këshillat tashmë kanë një paketë të veglave të nevojshme për të lehtësuar procesin e buxhetimit dhe decentralizimin e buxhetit;
- ✓ Organizimi i brendshëm i Këshillave është përmirësuar përmes mbështetjes së Projektit në përgatitjen e përshkrimeve të detyrave të punës, organogrameve të reja, zhvillimit të njëjseve ekzistuese dhe krijimit të pozitave dhe zyrave të reja në kuadër të Sekretariateve;
- ✓ Kapaciteti i Komisioneve të Përhershme të Këshillave për përmbushjen e detyrimeve të tyre, raportimin në Këshillat përkatës dhe komunikimin me Sekretariatet është zhvilluar përmes aktiviteteve të Projektit për zhvillimin e kapaciteteve si dhe propozimeve dhe rekomandimeve të Projektit në këto fusha;
- ✓ Bashkëpunimi dhe ndërlidhja e dy Këshillave është zhvilluar dhe është siguruar harmonizimi i rregulloreve, PSV-ve, vendimeve etj., përmes mbështetjes së përhershme të Projektit në këtë drejtim;
- ✓ Marrëdhëniet me publikun të të dy Këshillave janë përmirësuar; Projekti ka ofruar për Këshillat disa dokumente që kanë për qëllim garantimin e transparencës së aktiviteteve të Këshillave.

Aspektet kryesore për zhvillimin e mëtutjeshëm të organizativ dhe funksional të KGJK dhe KPK:

- Të dy Këshillat duhet ti vazhdojnë aktivitetet e tyre që kanë për qëllim hartimin, aprovimin dhe zbatimin e akteve nënligjore të përcaktuara në amendamentet e reja në LKGJK, LKPK, LGJ dhe LPSH. Rekomandohet zhvillimi i kapaciteteve në këtë drejtim;
- Për funksionalizimin e plote të Sekretariatit të KPK duhet të ndërmerren disa masa nga KPK;
- Të dy Këshillat duhet të sigurojnë zbatimin e rekomandimeve të Projektit lidhur me Planet Strategjike përkatëse, Planet e Veprimt dhe Planet e Monitorimit dhe Vlerësimit dhe harmonizimin e Planeve Strategjike me Planet Vjetore;
- Rekomandohet që koncepti dokumenti për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të zhvillohet nga Këshillat dhe të përdoret për krijimin e një politike dhe standardeve për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Komisionet e Këshillave për Buxhet duhet të marrin përgjegjësinë për zbatimin e rekomandimeve të përfshira në manualin për buxhetim të përgatitur nga Projekti;
- Këshillat dhe Akademia Gjyqësore e Kosovës duhet të krijojnë mekanizma të qartë të bashkëpunimit në fushën e trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve pas miratimit të LAGJK nga Kuvendi;
- Bashkëpunimi mes KGJK dhe Kryetarëve të Gjykatave dhe KPK dhe Kryeprokurorëve ka nevojë për përmirësim të mëtutjeshëm;
- Rekomandohet fuqishëm zhvillimi i aktiviteteve të vazhdueshme për zhvillimin e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillave dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Emërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve

Amendamentet në Ligjet për KGJK dhe KPK të miratuara me 28 Maj 2015 kanë krijuar përgjegjësi të reja për Këshillat në veçanti **për rregullimin dhe organizimin e provimeve për gjyqtarë dhe prokurorëve, dhe për vlerësimin e tyre gjatë mandatit fillestar**. Njëkohësisht, amendamentet në Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit kanë **ndryshuar kushtet dhe kërkesat për kandidatët** dhe gjyqtarët dhe prokurorët e sapo-emëruar, duke ndryshuar kështu fazat fillestare dhe përfundimtare të për zgjedhjes. Në këtë mënyrë është reformuar tërë procesi i përzgjedhjes dhe është rritur roli i Këshillave, që aktualisht janë autoritetet e vetme përgjegjëse për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim si gjyqtarë dhe prokurorë. Kjo është në përputhje me Kushtetutën, standardet Evropiane dhe Ndërkombëtare dhe me rekomandimet relevante të Projektit.

Gjithashtu, amendamentet e reja janë marrë parasysh gjatë shqyrtimit të akteve nënligjore ekzistuese dhe PSV-ve si dhe gjatë përgatitjes së tyre të reja. Lidhur me Rregulloret e reja të hartuar për emërimet, duhet të theksohet se janë bërë disa ndryshime të konsiderueshme në modelin e rekrutimit, përzgjedhjes, nominimit dhe emërimit të kandidatëve dhe programeve fillestare të trajnimit. Për dallim nga sistemet e mëparshme në të cilat kandidatët për pozitë të gjyqtarëve janë zgjedhur për të ashtuquajturin programin PFTL të menaxhuar nga IGJK (dhe vetëm pas trajnimit fillestar, kanë fituar të drejtën për të aplikuar dhe për tu propozuar për emërim nga Këshillat), sipas amendamenteve të reja ligjore, kandidatët tashmë do të nënshtrohen provimit që menaxhohet tërësisht nga KGJK dhe KPK në

fund të të cilit, nëse rezultojnë pozitivisht, propozohen menjëherë për emërim. Vetëm pas emërimit të tyre, gjyqtarët dhe prokurorët e rinj marrin pjesë në trajnimin fillestar të obligueshëm 12 mujor.

Gjatë fazës së parë të implementimit, Projekti ka ofruar mbështetje për KGJK për hartimin e

Rregullores për Emërimin e Gjyqtarëve dhe Rregulloren për Emërimin e Prokurorëve si dhe për përgatitjen e PSV-ve përkatëse. 'Manualet' që përmbajnë PSV-të dhe udhëzimet për implementimin e duhur të PSV-ve u janë shpërndarë KGJK-së dhe KPK-së dhe pilot trajnimet janë realizuar nga Projekti për anëtarët e Këshillave, anëtarët e Komisioneve të Emërimit dhe Sekretariatet.

Në bazë të përvojës së mëparshme dhe pas amendamenteve të reja ligjore që ndikojnë në sistemin e rekrutimit dhe emërimit të gjyqtarëve, Projekti ka qenë i përfshirë në hartimin e Rregullores të reja të Këshillave për Rekrutimin, Emërimin de Ri-Emërimin, dhe hartimin e PSV-ve të reja për zbatimin e Rregullores. Sfida kryesore e Këshillave dhe për Projektin ka qenë përgatitja e **PSV-ve të reja për provimin me shkrim për kandidatët**. Kjo kompetencë e re e KGJK-së dhe KPK-së që është paraparë në amendamentet e fundit ligjore duhet të kuptohet dhe zbatohet në mënyrë adekuate. Duhet të vendosen rregulla shumë të qarta, të detajuara dhe transparente procedurale dhe të aplikohen për të gjithë kandidatët.

KPK ka aprovuar Rregulloren për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Ri-emërimin e Prokurorëve me 1 Dhjetor 2015, PSV-të të përgatitura bashkërisht nga Projekti dhe hapja e shpalljes për emërimin e prokurorëve. KGJK ende duhet të miratojë Rregulloren e re dhe PSV-të që janë përgatitur nga Projekti dhe dorëzuar në KGJK dhe KPK.

Të dy Këshillat ende duhet të adresojnë **fazën e planifikimit** në procesin e rekrutimit dhe emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Faza planifikuese e rekrutimit dhe emërimit të gjyqtarëve është parakusht shumë i rëndësishëm për suksesin e tërë procesit. Duhet të bëhet një dallim i qartë dhe priorizim i emërimit, transferimit dhe ngritjes në detyrë të gjyqtarëve. Projekti rekomandon që Këshillat të kërkojnë nga Njësitë e Performancës të analizojnë raportet e rregullta vjetore të Kryetarëve të Gjykatave dhe të përgatisin një vlerësim të numrit të gjyqtarëve të rinj të nevojshëm për secilën gjykatë. Për analizën e lartpërmendur mund të ketë nevojë për

përgatitjen e indikatorëve të veçantë. Konkludimet dhe vlerësimi përfundimtar duhet të përgatitet nga Projekti. Në këtë mënyrë, analiza e nevoja e prezantuar nga Kryetarët e Gjykatave dhe konkludimet dhe vlerësimi nga Këshilli do të jenë baza më e besueshme për planifikimin e procesi të rekrutimit dhe emërimit të gjyqtarëve të rinj. Në këtë drejtim, Strategjia e BNJ dhe Koncept Dokumenti për trajnime i dorëzuar nga Projekti duhet të merren parasysh. Koordinimi i proceseve planifikuese ndërmjet KGJK, KPK dhe IGJK (AGJK) rekomandohet fuqishëm.

Për emërimin e përhershëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve, amendamentet në Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit kanë paraparë një fazë të re në karrierën e gjyqtarëve dhe prokurorëve: një periudhë të trajnimit fillestar prej 12 muajve në kuadër të mandatit fillestar 3 vjeçar. Amendamentet në LKGJK dhe LKPK kanë rregulluar në mënyrë konsistente procesin e vlerësimit të performancës, përmes një reference specifike në vlerësimin e fazës fillestare të trajnimit. Gjithashtu, projektligji për Akademinë Gjyqësore është duke u përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, me qëllim të zëvendësimit të IGJK ekzistuese për ofrimin e trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë. Duke marrë parasysh të mësipërmet, Draft Rregullorja e KGJK është fokusuar në procesin e rekrutimit, mirëpo nuk përfshin kritere dhe rregulla të procedurës të reja për procesin e ri-emërimit. Megjithatë, është e qartë se qëllimi i ligjvënësit është reformimi i tërë procesit të përzgjedhjes dhe emërimit, duke përfshirë fazën e ri-emërimit, dhe dispozitat e reja do të duhet të harmonizohen gjatë tërë procesit, duke përfshirë ato që ndërlidhen me fazën e trajnimit fillestar. Për këtë arsye, implementimi i këtyre reformave kërkon vëmendje të veçantë, kryesisht për të siguruar që rolet dhe përgjegjësitë e KGJK, KPK dhe “Akademisë Gjyqësore” të mos jenë vetëm në përputhje me

kornizën ligjore (dhe standardet) por që të formulohen në mënyrë të qartë, për të shmangur konfliktin e mundshëm të kompetencave.

Të dy Këshillat duhet të analizojnë dhe vlerësojnë implementimin e dispozitave të reja ligjore lidhur me rekrutimin, përzgjedhjen, emërimin dhe ri-emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, aktet nënligjore dhe PSV-të, performancë në Komisioneve të Emërimit dhe Ri-emërimit, kontributi i Sekretariateve dhe të merren masat përkatëse për përmirësimin dhe zhvillimin e procedurave të emërimit dhe ri-emërimit. Ky proces duhet të zhvillohet pas përfundimit të procesit të emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas sistemit të ri të emërimit nga Këshillat.

Aktivitetet për zhvillimin e kapaciteteve për procedurat e emërimit të përfunduara nga Projekti kanë rezultuar në përgatitjen e një ANT, programeve dhe moduleve të trajnimit, propozimeve për mënyrat e organizimit dhe zhvillimit të trajnimeve dhe një paketë të plotë të materialeve që mund të përdoren nga Këshillat gjatë trajnimeve të ardhshme. Në funksion të arritjes së këtij qëllimi, bashkëpunimi i ardhshëm me IGJK (AGJK) rekomandohet fuqishëm.

Duke marrë parasysh presionin nën të cilin janë duke funksionuar KGJK dhe KPK (për shkak të afateve kohore të vendosura në amendamentet ligjore, nevoja për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së gjyqtarëve të rinj, etj.), ka mundësi që implementimi i kornizës së re ligjore dhe ndryshimi i akteve nënligjore përkatëse do të kërkojë përpjekje shtesë gjatë viteve të ardhshme për të siguruar koordinimin, konsistencën, harmonizimin dhe përputhshmërinë me standardet dhe praktikatat e mira Evropiane dhe ndërkombëtare.

Rezultatet e arritura lidhur me emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve

- ✓ Projekti ka ofruar mbështetje të plotë për të dy Këshillat për hartimin e Rregulloreve për Emërimin, harmonizimin e Rregulloreve të dy Këshillave, përgatitjen e PSV-ve dhe zhvillimin e kapaciteteve të personave përgjegjës për procedurat e emërimit përmes trajnimeve;
- ✓ Projekti u ka siguruar dy Këshillave Manuale që përmbajnë PSV-të për procedurat e emërimit dhe udhëzime për implementimin e rregullt të PSV-ve;
- ✓ Kapaciteti i anëtarëve të KGJK dhe KPK, anëtarëve të Komisioneve për Emërim dhe Rishqyrtim dhe personelit mbështetës të Këshillave që janë përgjegjës për procedurat e emërimit është zhvilluar dhe fuqizuar dhe anëtarët e Komisioneve kanë kapacitete për planifikimin, raportimin, analizimin, ekzaminimin, vlerësimin dhe propozimin e kandidatëve për Këshillat;
- ✓ Analizat, rekomandimet dhe studimet krahasuese të Projektit për sistemin e emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së ndryshimeve dhe plotësimeve të fundit në LKGJK, LKPK, LGJ dhe LPSH, që kanë hyrë në fuqi nga data 15 Korrik 2015;
- ✓ Sistemi i ri për rekrutimin, përzgjedhjen, nominimin dhe emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve është në përputhje me praktikën e mira Evropiane dhe rekomandimet e Projektit;
- ✓ Pas miratimit të amendamenteve të fundit në ligjet përkatëse, Projekti u ka dorëzuar Këshillave, Komisioneve dhe Grupeve Punuese të tyre, rekomandime të qarta për Rregulloret e reja për rekrutimin, provimin dhe emërimin si dhe PSV-të e reja për tërë procesin e rekrutimit, provimit, vlerësimit dhe nominimit të kandidatëve. Rrjedhimisht, të dy Këshillat kanë rregulla të qarta procedurale për procedurat e reja të emërimit dhe kanë kapacitetin për implementimin e këtyre procedurave.

Aspektet kryesore për zhvillimin e mëtutjeshëm sa i përket emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve:

- Miratimi i LAGJK dhe harmonizimi me amendamentet e fundit ligjore të LKGJK, LKPK, LGJ dhe LPSH me Ligjin për AGJK, posaçërisht sa i përket trajnimit fillestar për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të konsiderohet si njëra nga detyrat kryesore për periudhën e ardhshme;
- Ka nevojë për shtjellim të mëtutjeshëm të dispozitave përkatëse në aktet nënligjore lidhur me ri-emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe shtjellimin e PSV-ve përkatëse për ri-emërimin në pajtim me amendamentet e fundit ligjore dhe LAGJK;
- Miratimi i Draft Rregullores së KGJK për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Ri-Emërimin dhe hartimi i PSV-ve përkatëse;
- Planifikimi i procedurës së emërimit në kuptim në BNJ, buxhetit, programeve të trajnimit, trajnerëve, mentorëve etj. duhet të shqyrtohet si hapi i ardhshëm në aktivitetet e dy Këshillave;
- Vlerësimi i implementimit të Rregullores së re të miratuar për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Ri-Emërimin e Prokurorëve, Funksionimin e Komisionit për Emërim dhe implemetimin e PSV-ve të reja të përgatitura; Sipas vlerësimit të KPK, duhet të ndërmerren masat përkatëse për përmirësimin e procedurave të emërimit dhe ri-emërimit;
- Trajnime të vazhdueshme duhet të organizohen nga Këshillat, IGJK (dhe/ose partnerët ndërkombëtarë) sipas programit të trajnimit dhe materialeve të dorëzuara nga Projekti për Këshillat.

Vlerësimi i performancës, transferimit dhe ngritjes në detyrë të gjyqtarëve dhe prokurorëve

Përmes amendamenteve të fundit në LKGJK dhe LKPK që kanë hyrë në fuqi me 15 Korrik 2015 janë themeluar Komisionet e Përhershme të Vlerësimit të Këshillave. Gjithashtu është përcaktuar se vlerësimi i performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve me mandate fillestar do të zhvillohet së paku dy herë “një herë pas trajnimit fillestar dhe një herë në fund të mandatit fillestar”. Sa i përket gjyqtarëve dhe prokurorëve me mandate të përhershëm, vlerësimi zhvillohet ‘çdo tri vite’. Dispozitat e reja të të dyja ligjeve e përcaktojnë përbërjen e Komisioneve dhe kërkesat për anëtarët e Komisioneve.

Duhet të konkludohet se amendamentet ligjore, sa i përket vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve përcaktojnë një kornizë të re dhe më të mirë ligjore për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve që duhet të implementohen përmes ndryshimeve përkatëse në Rregulloret për Vlerësim, përmes ndryshimit dhe përmirësimit të PSV-ve dhe zhvillimit të kapaciteteve të organeve dhe personave përgjegjës për procedurat e vlerësimit. Gjithashtu, dispozitat e reja ligjore duhet të konsiderohen si një hap përpara drejt harmonizimit të sistemit të vlerësimit të gjyqtarëve në Kosovë me standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare. Megjithatë, e drejta e ankesës pranë një Gjykate të pavarur kundër vlerësimit nga gjyqtarët dhe prokurorët sipas standardeve ndërkombëtare ende duhet të rregullohet me ligj.

Kërkohen përpjekje të shtuara për zhvillimin e kapaciteteve të anëtarëve të Komisioneve Vlerësuese dhe personelit mbështetës përgjegjës për procedurat e vlerësimit. Procesi i vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të përmirësohet, në mënyrë që arrijtjet individuale, aftësitë, kapacitetet dhe zotësitë të vlerësohen jo vetëm në bazë të kritereve objektive të përcaktuara në ligjet përkatëse por gjithashtu duke marrë parasysh

vlerësimin adekuat dhe profesional të të gjitha informatave relevante. Zhvillimi i karrierës së gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të bazohen në vlerësimin e rregullt të performancës së tyre që duhet të jetë i besueshëm dhe i arsyetuar mirë. Vendimet e Këshillave për vlerësimin e performancës duhet të bazohen në raportet e Komisionit Vlerësues dhe të gjitha dokumentet e mbledhura dhe të analizuar nga Komisionet.

Procesi formal dhe i përgjithësuar i vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të ndërpritet dhe ti hapë rrugë vlerësimit të motivuar, individual dhe specifik në të ardhmen. Kjo do të rrisë besimin e komunitetit profesional në Këshillat.

Aktivitetet për zhvillimin e kapaciteteve për vlerësimin e performancës të zhvilluara nga Projekti u kanë siguruar Këshillave, Komisioneve të tyre të Vlerësimit dhe personelit mbështetës me ANT, programet dhe modulet e trajnimit, propozimet për mënyrat e organizimit dhe zhvillimit të trajnimeve dhe një paketë të plotë të materialeve që mund të përdoren për trajnimet e vazhdueshme në të ardhmen. Për arritjen e këtij qëllimi, rekomandohet fuqishëm zhvillimi i bashkëpunimit me IGJK (AGJK).

Vlerësimi i gjyqtarëve:

Projekti e ka mbështetur KGJK-në gjatë Fazës së Parë të Implementimit për ndryshimin e Rregullores së KGJK për Vlerësimin e Gjyqtarëve, përgatitjen e PSV-ve të reja dhe zhvillimin e kapaciteteve të anëtarëve të Komisioneve Vlerësuese dhe personelit mbështetës.

Duhet të theksohet se amendamentet e reja ligjore kërkojnë **rishikimin dhe ndryshimin e Rregullores për Vlerësimin e Gjyqtarëve**. Gjatë këtij shqyrtimi, gjetjet dhe rekomandimet e Projektit të përfshira në Katalogun e Rekomandimeve duhet të analizohen dhe të zbatohen sipas nevojës. Dokumentet e politikave dhe objektivat strategjike lidhur me procedurat e vlerësimit, përveç analizës së çështjeve dhe kufizimeve në implementimin e

këtyre procedurave, gjithashtu duhet të merren parasysh.

Në vijim janë paraqitur gjetjet përfundimtare të Projektit lidhur me problemet me të cilat është duke u ballafaquar KGJK dhe Komisioni i Vlerësimit gjatë zhvillimit të vlerësimit si dhe fushat në të cilat ka nevojë për përmirësime:

Komisioni Vlerësues ka kryer vlerësimin e performancës vetëm për gjyqtarët me mandat fillestar. **Nuk është zhvilluar vlerësimi i performancës për gjyqtarët me mandat të përhershëm.**

Komisionit Vlerësues shpesh **nuk i sigurohen të gjitha informatat relevante të nevojshme** për kryerjen e suksesshme të procesit të vlerësimit të performancës. Në disa raste, informatat e siguruar nga KGJK, Kryetarët e Gjykatave dhe Gjyqtarët nën vlerësim, nuk përputhen.

Raportet Statistike ende luajnë një rol shumë të rëndësishëm në procesin e vlerësimit individual të punës së Gjyqtarëve, megjithëse Rregullorja përcakton se statistikat nuk janë burim primar i informacionit. Në disa raste, dokumenti i vetë-vlerësimit nuk përmban informata të besueshme. Gjyqtarët duhet të trajnohen dhe të udhëzohen për plotësimin e duhur të formularëve të vetë-vlerësimit. Manuali i Projektit i dorëzuar në KGJK gjatë zhvillimit të pilot trajnimeve përmban këto udhëzime dhe mund të përdoret për përmirësimin e mëtutjeshëm të procesit të vetë-vlerësimit.

Raportet e Kryetarëve të gjykatave përkatëse mund të konsiderohen se bazohen në PSV-të e dorëzuara nga Projekti. Në disa raste, Kryetarët e Gjykatave të caktuara kanë përdorur të njëjtin vlerësim, me të njëjtin tekst për disa gjyqtar, pa shënuar asgjë specifike për gjyqtarin e caktuar.

Raporti i Kryetarit të Gjykatës si njëri ndër burimet kryesore të informacionit për procedurat e vlerësimit duhet të jetë i qartë dhe konkret dhe të përmbajë vlerësime të individualizuara për punën dhe aftësitë e secilit gjyqtar.

Në KGJK janë dorëzuar disa rekomandime ku janë identifikuar pikat e dobëta të

performancës së gjyqtarëve, mirëpo deri më tani, KGJK nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim lidhur me këtë. KGJK nuk përdor një mekanizëm për trajtimin e rekomandimeve të Komisioneve. **Nevojitet përgatitja e një plani të veçantë nga KGJK për zbatimin e rekomandimeve** të Komisionit Vlerësues për trajnime shtesë specifike për gjyqtarët nën vlerësim.

Burimet shtesë të informacionit qëduhet të merren parasysh sipas Rregullores sëKGJK-së, janë si vijon: opinion i kolegjiuemeve të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Gjyqtaret e Gjykatave Themelore dhe opinion i Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme për Gjyqtaret nga Gjykata e Apelit nën vlerësim.

Vlerësimi i prokurorëve

Projekti ka mbështetur Këshillin Prokurorial të Kosovës në përgatitjen dhe miratimin e **Rregullores së parë të KPK-së për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve në vitin 2013.** Dispozitat e kësaj Rregullore janë përgatitur pas një hulumtimi të gjerë të standardeve ndërkombëtare dhe një analize krahasuese të praktikave të mira. Në këtë mënyrë, balanca mes vlerësimit të objektivave dhe kritereve subjektive është sqaruar. Indikatorët e matshëm për vlerësimin e secilit kriter janë paraparë. Disa burime të informacionit janë përcaktuar në rregullore. Roli i indikatorëve statistikor është zvogëluar në krahasim dhe burimet e tjera të informacionit.

Është bërë një dallim i qartë në mes të vlerësimit individual të prokurorëve nga Komisioni Vlerësues dhe Këshillit dhe vlerësimit të performancës së prokurorëve nga NJSHPP dhe është shpjeguar dhe kuptuar nga personat përgjegjës për këto vlerësime.

Njëkohësisht, Projekti i ka siguruar KPK-së **PSV-të për procedurat e vlerësimit**, siç është formulari i vetë-vlerësimit, shablloni i raportit të Kryeprokurorit për vlerësimin e performancës individuale të prokurorëve, një Raport për Komisionet e Vlerësimit, etj.

Amendamentet ligjore të miratuara në vitin 2015 duhet të konsiderohen si hapi i ardhshëm

dhe më i rëndësishëm legjislativ drejt zhvillimit të sistemit të vlerësimit të prokurorëve.

Në vijim janë paraqitur gjetjet dhe konkludimet përfundimtare të Projektit lidhur me procedurat e vlerësimit të prokurorëve:

KPK ka miratuar amendamentet e Rregullores me 30 Dhjetor 2015 në pajtim me amendamentet ligjore të mbështetura nga Projekti. Vlerësimi i procedurave të zhvilluara nga Komisioni i KPK-së në vitin 2014 dhe 2015 dhe amendamentet ligjore në fushën e vlerësimit të performancës së prokurorëve kanë shërbyer si bazë për rishikimin e Rregullores së KPK-së.

Amendamentet Ligjore dhe amendamentet në Rregulloren e KPK-së nuk kërkojnë ndryshimin e PSV-ve për procedurat e vlerësimit.

Çështjet kryesore, kufizimet dhe shqetësimet lidhur me procedurat e vlerësimit të prokurorëve **mund të zgjidhen përmes masave organizative dhe menaxheriale**, aktiviteteve për zhvillimin e kapaciteteve të anëtarëve të Komisionit dhe personelit mbështetës dhe përmirësimit të bashkëpunimit të brendshëm brenda organeve dhe mes personave përgjegjës për këto procedura.

Aspektet e veçanta në vijim duhet ende të adresohen: **Raporti i Kryeprokurorit** si njëri ndër burimet kryesore të informacionit për procedural e vlerësimit duhet të jetë i qartë dhe konkret dhe të përmbajë një vlerësim individual të performancës, kapacitetit dhe aftësive të secilit prokuror. **Burimet shitesë të informacionit** mund të parashihen në Rregulloren e KPK, si p.sh raportet për ankesat e dorëzuara tek Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit. Të gjitha dokumentet e mbledhura për vlerësimin e performancës dhe që merren parasysh nga KV duhet të ruhen në mënyrë të rregullt dhe të përfshihen në **dosjen personale** të prokurorit përkatës. Vlerësimi i performancës së anëtarëve të Komisionit Vlerësues duhet të rregullohet nga Këshilli.

Rezultatet e arritura lidhur me vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve

- ✓ Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ndryshimet dhe plotësimet e reja në LKGJK dhe LKPK për Komisionet e Vlerësimit janë në përputhje me rekomandimet e Projektit.
- ✓ Projekti ka ofruar mbështetje të plotë për KGJK për shqyrtimin, komentimin dhe ndryshimin e Rregulloreve për Vlerësimin e Gjyqtarëve dhe përgatitjen e PSV-ve për vlerësimin e gjyqtarëve;
- ✓ Komisioni i KGJK është mbështetur në vazhdimësi gjatë zbatimit të PSV-ve dhe gjatë procesit të analizimit dhe vlerësimit të procesit të vlerësimit;
- ✓ Projekti ka arritur rezultate të shkëlqyera në krijimin e sistemit të ri të vlerësimit për prokurorë në pajtim me LKPK; Është bërë dallimi i qartë ndërmjet vlerësimit të prokurorëve dhe të prokurorive përmes miratimit të një Rregullore të re për Vlerësimin e Prokurorëve në vitin 2013 dhe krijimin e Komisionit Vlerësues të KPK;
- ✓ Projekti ka siguruar për të dy Këshillat një Manual që përmban PSV-të për procedurat e vlerësimit dhe udhëzimet për implementimin e drejtë të PSV-ve;
- ✓ Kapaciteti i anëtarëve të KGJK dhe KPK, anëtarëve të Komisionit Vlerësues dhe personelit mbështetës të Këshillave është zhvilluar dhe anëtarët e Komisioneve tani kanë kapacitetin e nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kriterëve objektive, indikatorëve të matshëm dhe burimeve të qarta të informacionit;
- ✓ Komisionet Vlerësuese të Këshillave janë në gjendje që të planifikojnë në mënyrë adekuate, të raportojnë dhe të analizojnë procedurat e vlerësimit; Projekti ka realizuar disa trajnime me këto Komisione në këtë drejtim dhe u ka dorëzuar Këshillave programin e trajnimit, ANT, materialet dhe rekomandimet për trajnimet e ardhshme;
- ✓ Pas ndryshimeve dhe plotësimeve të fundit ligjore, Projekti i ka siguruar KPK-së propozime të qarta për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Vlerësimin e Prokurorëve, që janë pranuar dhe miratuar.

Aspektet kyçe për zhvillimin e mëtutjeshëm të vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve:

- Ende ka nevojë për shqyrtimin dhe ndryshim/plotësimin e Rregullores së KGJK për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve sipas amendamenteve ligjore dhe rekomandimeve të Projektit dhe në pajtim sa më të madh me standardet Evropiane;
- Të dyja Rregulloret duhet të ndryshohen dhe plotësohen pas miratimit të LAGJK kur do të rregullohet më mirë trajnimi fillestar i gjyqtarëve dhe prokurorëve. Rrjedhimisht, dispozitat përkatëse lidhur me vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj gjatë emërimit fillestar tre vjeçar duhet gjithashtu të rregullohen përshtatshëm;
- PSV-të për procedurat e vlerësimit duhet të rishikohen dhe përmirësohen pas amendamenteve në Rregulloret përkatëse dhe kurdo që Këshillat e konsiderojnë të nevojshme;
- Vlerësimi i implementimit të Rregulloreve dhe implementimi i PSV-ve duhet të bëhet në baza vjetore nga Këshillat;
- Raportet vjetore të Komisioneve, duke përfshirë Komisionet e Vlerësimit, duhet të shërbejnë si bazë për vlerësimet e Këshillave dhe për paraqitjen e masave të tjera për përmirësimin e procedurës;
- Trajnimet e vazhdueshme duhet të organizohen nga Këshillat (dhe/ose partnerët ndërkombëtar) pas dorëzimit të programit të trajnimeve dhe materialeve tek Këshillat.

Ngritja në detyrë dhe transferimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve

Gjatë Fazës së Parë të Implementimit të Projektit, korniza ligjore për transferimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe prokurorëve është analizuar dhe janë përgatitur konkludimet në vijim:

Kriteret për transferimin dhe ngritjen në detyrë dhe mbrojtjet kryesore procedurale duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë me ligj. Ligji duhet të përcaktojë qartë se gjyqtarët/prokurorët nuk do të transferohen kundër vullnetit të tyre. **Nevoja për transferim dhe ngritje në detyrë duhet të vlerësohet nga KGJK/KPK në mënyrë të rregullt** për të siguruar që çdo gjyqtar/prokuror të ketë mundësinë të kërkojë një transferim ose ngritje në pozitë në një pozitë të lirë.

Transferimi dhe ngritja në pozitë e gjyqtarëve/prokurorëve duhet të **bazohet në rezultatet e një vlerësimi të rregullt**. Kjo do të sigurojë një **mjedis konkurrues** në të cilin gjyqtarët dhe prokurorët me performancë më të mirë stimulohen që të avancojnë në karrierën e tyre. Në veçanti, **një vlerësim i veçantë** i kandidatëve që priten të ngritën në pozitë mund të parashihet në Rregulloren për Vlerësimin ose Rregulloren për Transferime dhe Ngritje në Detyrë. Vlerësimi i rregullt i performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të luajë rol kyç në zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke përfshirë për transferime dhe ngritje në detyrë. Ky standard ndërkombëtar është paraparë në Rregulloret e KGJK dhe KPK. Megjithatë, vetëm implementimi i duhur i këtij standardi në Rregulloret e Këshillave do të ketë ndikim real në komunitetin gjyqësor dhe prokurorial. Monitorimi dhe vlerësimi i këtij procesi rekomandohet fuqishëm.

Ligji duhet të parashohë mundësinë e **ankesës** në një gjykatë të pavarur kundër të gjitha

vendimeve për transferim dhe ngritje në detyrë të gjyqtarëve/prokurorëve.

Duke qenë se me amendamentet ligjore në LKGJK dhe LKPK të vitit 2015 nuk janë përfshirë dispozita ligjore të nevojshme për transferimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përpjekjet kryesore duhet të orientohen në aktet nënligjore, PSV-të dhe në përmirësimin e ë gjitha rregullave dhe proceseve të vendimmarrjes të Këshillave për transferime dhe ngritje në detyrë. Megjithatë, parimi i ligjshmërisë, transparencës dhe konkurrencës së drejtë për transferimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të respektohet dhe garantohet me dispozita ligjore. Prandaj, ende rekomandohet përfshirja e këtyre çështjeve përmes amendamenteve ligjore. Projekti ka dorëzuar në KGJK një analizë të Rregullores së KGJK për Transferim dhe Ngritje në detyrë dhe ka propozuar ndryshime dhe plotësime në Rregullore sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare.

Koncept Dokumenti për transferim dhe ngritje në detyrë të prokurorëve është dorëzuar në KPK në vitin 2015. Ky dokument përmban të gjitha vlerësimet, analizat dhe gjetjet relevante që duhet të merren parasysh gjatë krijimit të një sistemi të ri dhe të qëndrueshëm për transferime dhe ngritje në detyrë.

Draft Rregullorja e KPK-së për Transferime dhe Ngritje në Detyrë e përgatitur së fundmi nga Projekti dhe Grupi Punues i KPK parasheh dispozita që rregullojnë procedurat në pajtim me kornizën ligjore.

Rezultatet e arritura lidhur me ngritjen në detyrë dhe transferimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve

- ✓ Dispozitat ligjore për transferim dhe ngritje në detyrë të gjyqtarëve dhe prokurorëve janë analizuar dhe vlerësuar nga Projekti dhe amendamentet përkatëse ligjore janë rekomanduar përshtatshmërisht; studimet krahasuese dhe referencat përkatëse në standardet e aplikueshme ndërkombëtare janë elaboruar nga Projekti dhe u janë dorëzuar Këshillave për diskutim;
- ✓ Amendamentet e reja të miratuara në LKGJK dhe LKPK nuk përmbajnë ndryshime ose plotësime lidhur me transferimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe prokurorëve; prandaj, dispozitat ekzistuese ligjore janë interpretuar përshtatshmërisht duke rishikuar dhe komentuar rregulloret e Këshillave dhe hartimin e propozimeve për Rregullore të reja;
- ✓ Projekti ka ofruar mbështetje të plotë për KGJK për shqyrtimin, komentimin dhe ndryshimin e Rregulloreve për Transferimin e Gjyqtarëve; rekomandimet përkatëse kanë për qëllim përmirësimin e sistemit dhe të sigurojnë përputhshmërinë e Rregullores me kornizën ligjore në fuqi;
- ✓ Projekti ka ofruar mbështetje për KPK për hartimin e një Rregullore të re për Transferimin dhe Ngritjen në Detyrë të Prokurorëve dhe PSV-të për procedurat përkatëse; dokumentet janë përgatitur së bashku me Grupin Punues të KPK dhe janë diskutuar në hollësi me akterët përkatës; Prandaj, draft dokumentet e reja janë bazë e shkëlqyeshme për miratimin dhe implementimin e mëtutjeshëm. Ato do të lehtësojnë punën e KPK në krijimin e një mekanizmi më të mirë për transferime dhe ngritje në detyrë;
- ✓ Projekti ka arritur rezultate shumë të mira në përgatitjen e koncept dokumentit për transferimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që përmban një analizë të thuktë të situatës aktuale si dhe propozime për opsione të ndryshme që kanë për qëllim përmirësimin e sistemit dhe sigurimin e zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve dhe prokurorëve në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- ✓ Të dy Këshillat kanë kapacitetin për të siguruar harmonizimin e Rregulloreve përkatëse për Vlerësimin dhe Rregulloreve për Transferimin dhe Ngritjen në Detyrë. Këto Rregullore kanë për qëllim garantimin e zhvillimit të drejtë dhe transparent të karrierës së gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- ✓ Kapaciteti i anëtarëve të Këshillave, Komisioneve të tyre dhe personelit mbështetës përgjegjës për transferimin dhe ngritjen në detyrë është fuqizuar. Prandaj, personat përgjegjës në të dy Këshillat kanë akumuluar njohuritë dhe përvojën e nevojshme për përmirësimin e kornizës rregullatore dhe zhvillimin e këtyre procedurave në mënyrë adekuate.

Aspektet kryesore për zhvillimin e mëtutjeshëm në lidhje me transferimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe prokurorëve:

- Amendamentet përkatëse ligjore lidhur me transferimin dhe ngritjen në detyrë në pajtim me standardet ndërkombëtare të rekomanduara nga Projekti, janë ende të vlefshme;
- Rregullorja e KGJK për Transferim dhe Ngritje në Detyrë duhet ende të shqyrtohet dhe amendamentohet sipas raporteve vlerësuese të Projektit dhe sipas rekomandimeve përkatëse;
- Draft Rregullorja për Transferimin dhe Ngritjen në Detyrë të Prokurorëve e përgatitur nga Projekti dhe Grupi Punues i KPK është aprovuar nga Këshilli;
- PSV-të për transferimin dhe ngritjen në detyrë duhet të përgatiten dhe të diskutohen me komunitetin profesional dhe të aprovohen nga Këshillat;
- Planifikimi i transferimeve dhe ngritjeve në detyrë nga këshillat dhe shpallja adekuate e pozitive të lira është parakusht i rëndësishëm për garantimin e transparencës, paanshmërisë dhe drejtësisë së proceseve dhe rekomandohet fuqishëm.

Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe prokurorëve

Korniza ligjore në Kosovë, duke përfshirë amendamentet e fundit ligjore që trajtojnë procedurat disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë, duhet të konsiderohen të pamjaftueshme sa i përket përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare dhe rekomandimet e projektit. Qysh në fillim të implementimit të tij, Projekti ka rekomanduar ndryshimin e LKGJK dhe LKPK dhe miratimin e Ligjit për ZPD për harmonizimin e dispozitave ligjore që trajtojnë përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Analiza e kornizës ekzistuese ligjore, studimi krahasues i praktikave të mira dhe referencave në standardet e aplikueshme ndërkombëtare janë përgatitur nga Projekti në një fazë shumë të hershme të implementimit të aktiviteteve disiplinore.

Është konkluduar se zhvillimi i sistemit disiplinor varet kryesisht nga rishikimi dhe ndryshimi i ligjeve përkatëse. Disa nga aspektet më të rëndësishme të amendamenteve të rekomanduara nga Projekti, janë si vijon: Kriteret për refuzimin e ankesave dhe inicimin e hetimeve si dhe kompetencat hetuese dhe të drejtat procedural të palëve duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë me ligj. Kriteret e pezullimit në rast të shkeljeve serioze disiplinore dhe procedura që dhen aplikuar duhet të përcaktohet me ligj. Me ligj gjithashtu duhet të përfshijë një përkufizim të qartë të shkeljes disiplinore. Ligjet aktuale për KGJK dhe KPK, në kundërshtim me Parimin e Sundimit të Ligjit, nuk përmbajnë rregulla të mjaftueshme dhe të qarta për çështjet siç është ndërprerja e seancave dëgjimore, afatet e parashkrimit, refuzimi i propozimeve të Zyrës së Prokurorit Disiplinor si dhe lidhur me përmbajtjen material të elementeve sikurse ‘masat disiplinore’ ose ‘pezullimi’. E drejta e ankesës pranë një gjykate të pavarur për të gjitha vendimet disiplinore që është në pajtim me standardet ndërkombëtare, ende nuk është rregulluar me ligj.

Mbështetja e Projektit për Këshillat dhe Komisionet e tyre Disiplinore gjatë implementimit të Projektit ka qenë e orientuar

drejt hartimit të ndryshimeve dhe plotësimeve në Rregulloret për Komisionet Disiplinore, përgatitjen e rekomandimeve për hartimin e Rregulloreve për përgjegjësinë disiplinore të anëtarëve të Këshillave, organizimin dhe funksionimin e ZPD, përgatitjen e PSV-ve për hetime disiplinore dhe procedura disiplinore, zhvillimin e trajnimeve, etj.

Duhet të theksohet se, në tërësi, kontributi i Projektit për përmirësimin e sistemit disiplinor për gjyqtarë dhe prokurorë ka qenë i konsiderueshëm dhe përmbajtësor. Megjithatë, shumica e ndikimeve negative të kornizës aktuale ligjore kanë qenë të pashmangshme dhe të pakalueshme përmes ndryshimit të akteve nënligjore, përgatitjes së PSV-ve dhe aktiviteteve për zhvillimin e kapaciteteve. Çështjet kryesore duhet të sqarohen me ligj – disa nga këto çështje duhet të sqarohen përmes amendamenteve në Ligjet për KGJK/KPK, ndërsa të tjera në Ligjin e ri për ZPD.

Prandaj, rekomandohet që Koncept Dokumenti për Projektligjin për ZPD dhe Koncept Dokumentet për procedurat disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë, Katalogu i Rekomandimeve, Libri i referencave në Standardet Ndërkombëtare, të gjitha të përgatitura nga projekti, duhet të përdoren gjatë çfarëdo iniciative legislative.

Manualet e përgatitura për KGJK, KPK dhe ZPD, që përmbajnë PSV-të përkatëse dhe udhëzimet për aplikimin e tyre, si dhe dokumentet mbështetëse që kanë për qëllim lehtësimin e zhvillimit të hetimeve disiplinore duhet të përdoren nga organet dhe personat përgjegjës për veprime disiplinore. Amendamentet dhe përmirësimet e këtyre manualeve duhet të shtjellohen dhe të përgatiten nëse parashikohet ndryshimi i legjislacionit primar dhe sekondar.

Anëtarëve të rinj të Këshillave dhe Komisioneve Disiplinore duhet tu sigurohet një paketë e plotë e dokumentacionit të Projektit që ndërlidhet me sistemin disiplinor për gjyqtarë dhe prokurorë. Kjo do të lehtësonte aktivitetet për zhvillimin e kapaciteteve të dy Këshillave në të ardhmen.

Rezultatet e arritura lidhur me sistemin disiplinor për gjyqtarë dhe prokurorë

- ✓ Mbështetja e Projektit për zhvillimin e sistemit disiplinor për gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë është ofruar në vazhdimësi gjatë tërë implementimit të Projektit. Raportet dhe analizat përmbajnë një vlerësim shumë të detajuar të sistemit ekzistues si dhe rekomandime dhe propozime të qarta për amendamentet përkatëse ligjore që janë të nevojshme për përmirësimin e sistemit disiplinor dhe për të siguruar implementimin e standardeve përkatëse ndërkombëtare;
- ✓ Rekomandimet dhe analizat janë të aplikueshme në procesin përkatës legjislativ. Ky proces do të lehtësohet përmes koncept dokumenteve përkatëse të përgatitura nga Projekti dhe të dorëzuara për Këshillat; rrjedhimisht, kapaciteti i Këshillave për analizën dhe vlerësimin e politikave për sistemin disiplinor është fuqizuar në masë të konsiderueshme;
- ✓ Në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, Projekti ka dorëzuar në KGJK, KPK dhe ZPD disa propozime konkrete për rishikimin e akteve nënligjore, PSV-ve për hetime disiplinore dhe procedura disiplinore, trajnime, etj. që kanë kontribuar në fuqizimin e organeve përgjegjëse për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- ✓ Projekti ka dorëzuar tek dy Këshillat dhe Komisionet e tyre Disiplinore, rekomandime për ndryshimin dhe plotësimet e Rregulloreve për Komisionet disiplinore, që kanë për qëllim arritjen e përputhshmërisë së plotë me ligjet përkatëse; Diskutimet me Komisionet e këshillave në këtë çështje kanë zhvilluar kapacitetin e Këshillave për interpretimin adekuat të dispozitave ligjore dhe implementimin e Rregulloreve;
- ✓ Projekti ka kryer një analizë dhe vlerësim shumë të detajuar të Rregullores së KGJK dhe draft Rregullores së KPK për Përgjegjësinë Disiplinore të Anëtarëve të KPK, që përmban disa rekomandime shumë të rëndësishme;
- ✓ Projekti ka përgatitur paketën e plotë të PSV-ve përkatëse për procedurat disiplinore ndaj gjyqtarëve, manualin me udhëzime për zbatimin e PSV-ve dhe zhvillimin e trajnimeve për KGJK, anëtarët e Komisionit Disiplinor dhe personelin mbështetës;
- ✓ Projekti i ka përgatitur të gjitha PSV-të përkatëse, Manualin dhe ka realizuar trajnimet për KPK, Komisionin Disiplinor të KPK dhe personelin mbështetës;
- ✓ E njëjta qasje është aplikuar për ZPD – Manuali, PSV-të për të gjitha aktivitetet lidhur me procedurat disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve janë përgatitur dhe dorëzuar në ZPD; trajnimet relevante janë realizuar nga Projekti;
- ✓ Prandaj, kapaciteti i organeve dhe personave përgjegjës për hetimet disiplinore dhe procedurat disiplinore është zhvilluar në masë të konsiderueshme;
- ✓ Mbështetje shtesë është ofruar për ZPD për përgatitjen e përshkrimeve të detyrave të punës dhe organogramit të ri, komentet në statusin e personelit të ZPD; propozime për rregullimin e brendshëm të ZPD që kanë për qëllim përmirësimin e organizimit dhe funksionimit të këtij organi;
- ✓ Projekti gjithashtu ka mbështetur KPK për përgatitjen dhe aprovimin e Kodit të Etikës për Prokurorë, Kodit të Etikës për Anëtarët e KPK dhe personelin mbështetës; Në këtë mënyrë,

rregullat e etikës janë të aplikueshme për të gjithë pjesëtarët e sistemit prokurorial dhe kontribuojnë në efikasitetin, paanshmërinë dhe pavarësinë e prokurorëve.

Aspektet kyçe për zhvillimin e mëtutjeshëm të sistemit disiplinor për gjyqtarë dhe prokurorë

- Sistemi disiplinor për gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë duhet ti nënshtrohet një shqyrtimi dhe amendamenti gjithëpërfshirës të LKGJK, LKPK si dhe miratimin e Ligjit të ri për ZPD; harmonizimi i plotë i dispozitave për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve është i rekomandueshëm. Kjo është njëra ndër fushat kryesore në të cilën ka nevojë për mbështetje të vazhduar ndërkombëtare në të ardhmen;
- Rekomandohet që Koncept Dokumenti për Projektligjin për ZPD dhe Koncept Dokumentet për Procedurat Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, Katalogu i Rekomandimeve, Libri i Referencave në Dokumentet Ndërkombëtare të përgatitura nga Projekti, të përdoren gjatë zhvillimit të iniciativave legislative;
- Manualet për KGJK, KPK dhe ZPD që përmbajnë PSV-të përkatëse dhe udhëzime për implementimin e tyre si dhe programi i trajnimit dhe materialet duhet të përdoren, rishikohen dhe përmirësohen përshtatshëm;
- Ka nevojë për përpjekje të mëtutjeshme për zhvillimin e kapaciteteve të anëtarëve të rinj të KGJK dhe KPK dhe anëtarëve të Komisioneve Disiplinore.

Sistemi Qendror Shtetëror i Dosjeve Penale (SQSHDP)

Mbështetja e Projektit për KGJK për zhvillimin e SQSHDP është zhvilluar përmes dy fazave në vijim:

Faza e parë, e implementuar në 2014, është fokusuar në vlerësimin e kornizës ligjore në Kosovë dhe bazës ligjore për krijimin e një sistemi qendror elektronik të dosjeve penale. Rrjedhimisht, një raport i detajuar analitik është përgatitur dhe dorëzuar në KGJK, që përmban propozime dhe rekomandime për hapat që duhen ndërmarrë nga KGJK, një vlerësim të kornizës aktuale legjislative dhe rregullative; një studim krahasues dhe sqarim të standardeve dhe praktikave të mira relevante ndërkombëtare; një dizajn të SQSHDP dhe, rekomandime lidhur me dispozitat legjislative dhe rregullative si dhe kërkesat institucionale dhe menaxhuese për krijimin e një sistemi funksional që është në përputhje me kërkesat ligjore dhe që është i kontrollueshëm.

Në bazë të rekomandimeve të Projektit të përshkuara më lartë, KGJK ka filluar procesin e implementimit, duke zhvilluar një program kompjuterik (softuer) të veçantë për SQSHDP dhe integrimin e këtij sistemi me sistemin informativ të KGJK.

Faza e dytë e mbështetjes së Projektit për KGJK për zhvillimin e SQSHDP është zhvilluar gjatë vitit 2015 kur Projekti ka dorëzuar në KGJK një vlerësim të operabilitetit të programit kompjuterik të SQSHDP së bashku me disa rekomandime për zhvillimin e përmbajtjes së sistemit (data bazës elektronike) si dhe një **Draft Rregullore për SQSHDP**. Rrjedhimisht, në Prill 2015, KGJK ka miratuar Rregulloren për SQSHDP dhe ka emëruar Drejtorin e SQSHDP.

Në ndërkohë, përmes amendamenteve ligjore në LKGJK me 28 Maj, 2015, KGJK është përcaktuar në mënyrë të qartë me ligj si autoriteti kompetent në fushën e çështjeve gjyqësore për menaxhimin e sistemit qendror të evidencës penale.

Projekti ka implementuar një pilot projekt 3 mujor në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan që ka pasur për qëllim përfshirjen e të dhënave të personave të dënuar në SQSHDP dhe identifikimin e problemeve në këtë proces.

Të gjitha lëndët penale të përfunduara nga gjyqtarët në këtë gjykatë nga viti 2000 deri në vitin 2014 janë shqyrtuar. Të dhënat relevante lidhur me 3775 persona të dënuar janë analizuar, nga të cilat të dhënat për 3256 persona janë përfshirë në bazën e të dhënave. Të dhënat e mbetura për 519 persona nuk janë përfshirë për shkak të mungesës së NPI (numrin personal të identifikimit) si dhe të dhënave të tjera të identifikimit ose për shkak të kufizimeve të tjera të programit kompjuterik.

Çështjet kyçe në vijim janë identifikuar gjatë pilot projektit:

Lidhur me Softuerin e SQSHDP:

- Jo të gjitha ligjet relevante janë përfshirë në rubrikën përkatëse të softuerit, duke përfshirë Kodin e Drejtësisë për të Mitur, Ligjin për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridik dhe Kodin Doganor të Kosovës;
- Pjesa për llojet e dënimeve nuk është në përputhje të plotë me KP dhe KDM si dhe Nenin 8.5 të Rregullores së KGJK;
- Softueri nuk i përfshin të gjitha të dhënat relevante personale siç është përcaktuar në Rregulloren e KGJK;
- Të dhënat personale të të huajve të dënuar në Kosovë nuk mund të përfshihen në sistem;
- Softueri nuk e ofron mundësinë e fshirjes së dënimeve pas rehabilitimit ligjor ose gjyqësor,

Lidhur me dosjet penale në Gjykata:

- Nuk ka indikacione të qarta nëse aktgjykimet janë përfundimtare;
- Mungesa e të dhënave personale për personat e dënuar është vërejtur në disa raste dhe duhet të konsiderohet si njëri ndër kufizimet kryesore gjatë përfshirjes së të dhënave në sistem.

Rezultatet e arritura lidhur me krijimin e SQSHDP

- ✓ Projekti ka dorëzuar në KGJK një raport analitik që përmban propozime dhe rekomandime për hapat që duhet të ndërmerren nga KGJK për krijimin e SQSHDP;
- ✓ Projekti ka analizuar dhe vlerësuar kornizën ligjore dhe rregullatore dhe ka rekomanduar amendamentet përkatëse;
- ✓ Projekti ka dorëzuar në KGJK një studim krahasues dhe një përmbledhje të praktikave të mira; një dizajn të SQSHDP dhe, kërkesat institucionale dhe menaxhuese për të siguruar që sistemi të jetë në përputhje me kërkesat ligjore, të jetë funksional, i dobishëm dhe i kontrollueshëm;
- ✓ Gjithashtu, Projekti ka vlerësuar operabilitetin e programit kompjuterik për SQSHDP të krijuar nga KGJK dhe ka rekomanduar zhvillimin e përmbajtjes së programit kompjuterik (bazës së të dhënave);
- ✓ Projekti ka përgatitur dhe dorëzuar në Këshill një Draft Rregullore për SQSHDP që është miratuar nga KGJK;
- ✓ Amendamentet në LKGJK kanë hyrë në fuqi me 15 Korrik 2015 dhe e përcaktojnë KGJK si institucionin që menaxhon SQSHDP sipas analizës dhe rekomandimeve të Projektit. Prandaj, baza ligjore për krijimin e SQSHDP është vendosur;
- ✓ KGJK ka emëruar një Drejtor të SQSHDP në kuadër të Sekretariatit dhe i dorëzuar këtij personi përgjegjësitë përkatëse për zhvillimin e SQSHDP;
- ✓ Projekti ka ofruar mbështetje të plotë për KGJK gjatë tërë këtij procesi dhe ka vazhduar me implementimin e pilot projektit 3 muhor në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan që ka pasur për qëllim përfshirjen e të dhënave në bazën e SQSHDP për personat e dënuar dhe identifikimin e problemeve që dalin nga ky proces;
- ✓ Projekti ka arritur rezultate të shkëlqyeshme gjatë implementimit të pilot projektit, rezultate këto që janë analizuar, përmbledhur dhe prezantuar përshtatshëm. Të gjitha lënët penale të përfunduara nga gjyqtarët në këtë gjykatë nga viti 2000 deri në vitin 2014 janë shqyrtuar. Të dhënat relevante lidhur me 3775 persona të dënuar janë analizuar, nga të cilat të dhënat për 3256 persona janë përfshirë në bazën e të dhënave. Problemet, pengesat dhe kufizimet përkatëse, si dhe gjetjet janë marrë parasysh gjatë aktiviteteve të ardhshme lidhur me SQSHDP.

Aspektet kyçe për zhvillimin e mëtutjeshëm të SQSHDP

- Programi kompjuterik (softueri) i SQSHDP duhet të ndryshohet dhe përshtatet me kornizën ligjore në fuqi në mënyre që të gjitha ligjet e aplikueshme, dënimet dhe të dhënat personale që kërkohet sipas ligjeve dhe Rregullores së KGJK përfshihen në kuadër të programit kompjuterik (softuerit);
- Pjesët relevante të programit kompjuterik (softuerit) lidhur me rehabilitimin ligjor dhe gjyqësor, amnistinë, faljen, etj. duhet të përfshihen në programin kompjuterik të SQSHDP dhe duhet të sigurohet përfshirja e të dhënave të rëndësishme që kanë të bëjnë me të kaluarën kriminale të personave;
- Përfshirja e të dhënave duhet të bëhet njëkohësisht me përfshirjen e të gjitha informatave relevante nga lëndët penale dhe të ekzekutimit; ndërlidhja mes lëndëve penale dhe lëndëve në ekzekutim duhet të jetë e qartë;
- Duhet të krijohet një praktikë e përbashkët për identifikimin e qartë të vendimeve (aktgjykimeve) që kanë hyrë në fuqi;
- Të dhënat personale të personave të dënuar, lëndët penale dhe të ekzekutimit duhet të jenë të besueshme dhe në përputhshmëri të plotë me ligjet, Rregulloren e KGJK dhe programin kompjuterik (softuerin) e SQSHDP; Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për këtë fushë të përgatitet dhe aprovohet nga KGJK
- Duhet të sigurohet ndërlidhja dhe qasja në data bazën e ARC për verifikimin e saktësisë së të dhënave personale të personave të dënuar gjatë përfshirjes së të dhënave në data bazën e SQSHDP;
- Rekomandohet implementimi i aktiviteteve të mëtutjeshme për përfshirjen e të dhënave nga Gjykatat Themelore në bazën e të dhënave sipas shembullit të pilot projektit të realizuar.

KOORDINIMI ME PARTNERËT TJERË NDËRKOMBËTARË

Koordinimi me partnerët tjerë ndërkombëtare gjatë implementimit të Projektit duhet të theksohet si një **shembull shumë i mirë** i aplikimit të metodave dhe mjeteve për zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në sektorin e drejtësisë në Kosovë.

Është fakt i njohur se në Kosovë veprojnë shumë programe dhe projekte ndërkombëtare në sektorin e drejtësisë që mbështesin organet gjyqësore në disa fusha. Disa nga këto projekte financohen nga Bashkimi Evropian, disa nga Qeveritë e Shteteve Evropiane, disa nga Qeveria Amerikane, USAID, etj. Bashkëpunimi dhe koordinimi me akterët relevant ka qenë shumë i rëndësishëm për të shmangur duplikimin e aktiviteteve dhe ndarjen e burimeve në mënyrë adekuate në mënyrë që kontributi i secilit partner ndërkombëtar të mbetet i vlefshëm dhe i mirëpritur. Në funksion të arritjes së këtij qëllimi, Projekti qysh në fillim të

implementimit të tij ka mbajtur qëndrimin që akterët ndërkombëtar duhet t'i shmangen konkurrencës dhe të punojnë së bashku, kur është e mundur, të marrin qëndrime të përbashkëta për çështje të ndjeshme ligjore dhe të koordinojnë aktivitetet në mënyrë që ti lejojë përfituesve që të luajnë një rol aktiv në to dhe të sigurojnë komunikimin me të gjithë akterët ndërkombëtar në të njëjtin nivel.

Në bazë të këtyre udhëzimeve, Projekti ka përdorur disa mjete për arritjen e rezultateve më të mira të mundshme në bashkëpunim me projektet dhe programet tjera, si vijon:

- Në fillim të fazës së implementimit të Projektit, Projekti ka nënshkruar një Plan të Përbashkët dhe të Integruar të Punës me Programin USAID/EROL me qëllim të shmangies së duplikimit të aktiviteteve dhe përcaktimin e prioriteteve për të dy projektet. Disa takime koordinuese janë zhvilluar me Programin EROL për vlerësimin e implementimit të këtij Plani;
- Ka pasur komunikim të shkëlqyeshëm me ekipin këshillëdhënës të EULEX; disa takime preliminare janë zhvilluar për shkëmbimin e opinionëve ligjore; janë përgatitur komente dhe propozime të përbashkëta nga këshilltarët në KPK dhe ekspertët e Projektit; janë zhvilluar takime të rregullta koordinuese nga Projekti gjatë implementimit të Projektit;
- Niveli shumë i lartë i bashkëpunimit mes Projektit dhe ekspertëve të Ambasadës së SHBA, Departamentit të Drejtësisë

gjithashtu vlen të theksohet. Projekti është ftuar që të kontribuojë në iniciativën e ekspertëve Amerikan për të përgatitur Projektligjin e ri për ZPD. Janë zhvilluar disa takime dhe diskutime, ja hartuar propozime të përbashkëta dhe komente në Projektligj, dhe Projektligji përfundimtar për ZPD është dorëzuar në MD nga ekspertët Amerikan.

Rekomandohet fuqishëm që Projektet tjera Evropiane të marrin këtë qasje, duke qenë se vlera dhe efektshmëria e saj janë vërtetuar gjatë tërë implementimit të Projektit.

MENAXHIMI I PROJEKTIT

Karakteristikat kryesore të menaxhimit dhe administrimit të Projektit janë sqaruar më poshtë në mënyrë që të theksohen sfidat dhe arritjet.

Janë disa aspekte të rëndësishme të cilat duhet të theksohen si parakushte të rëndësishme të implementimin e suksesshëm të Projektit.

Projektit është implementuar në pajtim me planin e Projektit dhe të gjitha aktivitetet janë përfunduar **në kohë dhe pa vonesa**.

Projektit ka pasur **komunikim të shkëlqyeshëm me përfituesit** që konsiderohet si parakushti më i rëndësishëm për rezultatet e Projektit.

Projektit ka qenë i përfshirë jo vetëm në implementimin e aktiviteteve të planifikuara, mirëpo edhe në aktivitete të rregullta të të dy Këshillave si dhe detyrat e rregullta të Këshillave, vendimet e tyre dhe çështjet të cilat ato i kanë trajtuar dhe kjo i ka lejuar Projektit që të zgjerojë fushëveprimin e aktiviteteve të Projektit dhe përshtatjen këtyre aktiviteteve me TR sipas nevojave dhe pritjeve reale të Këshillave.

Në kuadër të kornizës së përgjithshme të aktiviteteve të zhvilluara nga Projektit, mirëpo jashtë **TR përkatëse**, ekspertët kanë ndërmarrë iniciativa shtesë kur ka qenë e nevojshme.

Gjithashtu, **komente plotësuese të ekspertëve**, raporte dhe rekomandime janë siguruar jashtë fushëveprimit të Projektit me kërkesë të Këshillave. Shumica prej tyre – gjithsej (33) dokumente janë bashkëngjitur në formë të shtojcave në RTP-të dhe janë përmbledhur në një kapitull të veçantë 'Aktivitetet Tjera të Projektit'. Kjo tregon gatishmërinë dhe përkushtimin e Projektit për të reaguar në mënyrë të përshtatshme janë kërkesave të Këshillave. Megjithatë, duhet të theksohet se, në shumë raste kur Këshilli ka kërkuar kontributin e Projektit për aktivitete të paplanifikuara, afatet kanë qenë shumë të shkurtra, dhe kjo nuk ka lejuar një shqyrtim shterues të çështjeve përkatëse.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i menaxhimit të Projektit ka qenë angazhimi i ELASH **nga shtete të ndryshme Evropiane** (Austria, Portugalia, Italia, Franca, Gjermania, Belgjika, Bullgaria, Estonia, etj.) që kanë një shkallë të lartë të

përvojës ndërkombëtare dhe ofrojnë për përfituesit jo vetëm vlerësime, analiza dhe rekomandime bazuar në standardet ndërkombëtare, mirëpo edhe gjetje specifike në bazë të përvojës së tyre personale në shtetet përkatëse.

Bashkëpunimi me Zyrën e BE në Kosovë dhe Udhëheqësit e Aktiviteteve dhe niveli profesional i komunikimit i bazuar në respekt të ndërsjellët gjatë tërë kohëzgjatjes së Projektit mund të konsiderohet si parakusht i rëndësishëm për implementimin e suksesshëm të aktiviteteve të Projektit.

PËRMBAJTJA E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR

Raporti Përfundimtar paraqet të gjitha aktivitetet e zbatuara nga Projekti “Mbështetje për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës” nga Tetori 2011 deri në Prill 2016.

Raporti është ndarë në katër pjesë: Përmbledhja Ekzekutive, Aktivitetet e Zbatuara sipas Komponentëve, Aktivitetet Tjera të Zbatuara nga Projekti, Konkludimet dhe dhjetë (10) Shtojca.

Në **Përmbledhjen Ekzekutive** janë përshkruar karakteristikat kryesore të Projektit, rrethanat në terren dhe fushat kryesore në të cilat është angazhuar Projekti gjatë viteve të zbatimit të tij. Në këtë pjesë gjithashtu janë përmbledhur gjetjet kryesore, rekomandimet dhe arritjet si dhe disa nga aspektet më të rëndësishme negative dhe mangësitë. Gjithashtu, në këtë pjesë është theksuar mbështetja e vazhdueshme e Projektit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, rezultatet kryesore të arritura dhe fushat në të cilat kërkohet

më shumë angazhim nga Këshillat dhe mbështetje nga bashkësia ndërkombëtare.

Në **Pjesën Narrative** të Raportit janë analizuar dy grupe të veçanta të aktiviteteve të zhvilluara nga Projekti: aktivitetet e zbatuara sipas Komponentëve dhe Aktivitetet Tjera të Projektit. Në këtë pjesë janë përshkruara të gjitha gjashtëdhjetë e tetë (68) aktivitetet e Projektit dhe dyqind e shtatëdhjetë e tetë (278) produktet e Projektit, që i mbulojnë të gjitha rekomandimet në mënyrën më të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të mundshme, me qëllim të krijimit të një pasqyre të qartë të zbatimit të Projektit.

Secili aktivitet është përshkruar duke përdorur strukturën e njëjtë që fillon me periudhën e zbatimit, objektivat specifike, detyrat e përmbushura, konkludimet dhe rekomandimet. Në fund të secilit përshkrim është përfshirë një tabelë në të cilën janë radhitur produktet e përgatitura nga ekspertët që kanë punuar në aktivitetin përkatës si dhe referenca në raportet përkatëse tremujore. RTP-të dhe shtojcat e tyre janë përfshirë në tërësi si shtojca të Raportit Përfundimtar. Tabela e aktiviteteve dhe produkteve që është gjithashtu shtojcë e Raportit Përfundimtar mund të konsiderohet si udhëzues për orientimin e aktiviteteve të Këshillave dhe të projekte të ndryshme ndërkombëtare në të ardhmen, me qëllim të adresimit të rekomandimeve që kanë mbetur ende pa u realizuar. Kjo gjithashtu do të ndihmojë në kryerjen e detyrave të reja lidhur me organizimin dhe funksionimin e Këshillave, emërimin, transferimin, ngritjen në detyrë, vlerësimin, procedurën disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë, qasjen në drejtësi, etj.

Vlerësimi i shkallës së zbatimit të secilit rekomandim është dhënë në kuadër të përshkrimit të secilit Aktivitet, raportet e ekspertëve dhe aktivitetet e ndërlidhura në kuadër të Komponentit dhe Nën-Komponentit përkatëse si dhe në Katalogun e Rekomandimeve të përditësuar në vitin 2016, që janë përfshirë në formë të shtojcave të Raportit Përfundimtar. Dokumentet ndërkombëtare të cilat janë referuar në rekomandimet përkatëse mund të gjenden në Katalogun e Rekomandimeve dhe në raportet e ekspertëve. Dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare janë përmbledhur në një Libër të Referencave që është përgatitur nga Projekti në vitin 2014 dhe në Listën e Dokumenteve Ndërkombëtare që është ndarë sipas fushave dhe që është përgatitur në vitin 2016, që të dyja të bashkëngjitura në formë të shtojcave të Raportit Përfundimtar.

Pjesa e Konkludimeve e Raportit Përfundimtar përpiqet që të krijojë një pasqyrë të qartë të kontributeve më të rëndësishme të Projektit në fushën e zhvillimit organizativ dhe funksional të Këshillave, procedurën për emërimin, transferimin, ngritjen në detyrë, vlerësimin e performancës dhe procedurat disiplinore për gjyqtarë, si dhe përmirësimin e qasjes në drejtësi.

Kjo pjesë e raportit përfundimtar pasqyron shkallën aktuale të zbatimit të rekomandimeve më të rëndësishme të Projektit, të ndarë sipas fushave, si dhe arritjen e rezultateve të Projektit siç është planifikuar në fillim të zbatimit të Projektit. Kjo pjesë gjithashtu përmban **rekomandimet më të rëndësishme në ‘fushat kyçe’** të cilat ende kanë nevojë për vëmendje të veçantë, veprim të mëtutjeshëm nga Këshillat dhe mbështetje shtesë ndërkombëtare për kryerjen e përmirësimeve në nevojshme në organizimin dhe menaxhimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe rrjedhimisht, rritjen e besimit publik në sistemin gjyqësor.

DREJTORI I PROJEKTIT

Dr. Oliver Mader
Hulla & Co Human Dynamics KG

PARTNERËT E KONSORCIUMIT

DMI Associates S. a R.L (Francë)
Conselho Superior da Magistratura (Portugali)

EKIPI I PROJEKTIT

EKSPERTËT KYÇ:

Anita Mihailova
Placido Conde Fernandes
Jean-Jacques Heintz
Guy Van Craen

EKSPERTËT E LARTË

Agnes Bernhard
José Manuel Duro Mateus Cardoso
José Igreja de Matos
Artur Dionsio Oliviera
Patricia Helena Costa
Joao Rato
Thomas Krescher
Dorothee Walther
Adelina Sokoli-Pallaska
Pepa Laleva
Sharon Hanson Cooper
Maria Giuliana Civinini
Maria Cristina Di Cocco
Juris Avotins
Eugenio Maria Turco
Andrea Chmieliński Bigazzi
Michael Cunniff

Christian Elek
Leonat Rezniqui
Merita Emini
Dragomir Yordanov
Arno Pardla
Artur Jose Cordeiro
Arjan Alite

EKSPERTËT JUNIOR

Naureda Llagami
Rosica Yonkova
Agron Hoti
Florent Latifaj
Dren Rogova
Emrush Ujkani
Diturie Hoxha
Helena Papa
Vigan Rogova
Ilir Morina

STAFI I PROJEKTIT

Anduena Morina
Arben Fejza

MBËSHËTETJE PËR KËSHILLIN GJYQËSOR TË KOSOVËS DHE KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS
KONTRATA 2011 / 271 – 244 & 2014 / 350 – 729



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i
menaxhuar nga Zyra e Bashkimit
Evropian në Kosovë

